

Kumbona e së Diellës



Ringjallja e Krishtit - Auktionshaus Lempertz

Gëzuar Pashkët!

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.3/4, Mars - Prill 2020

PASHKËT NË KOHËN E COVID-19, PAPA FRANCESKO URON BESIMTARËT KATOLIK:

“Mos u dorëzoni, duhet të shpresojmë, Zoti është më i madh se errësira dhe vdekja”



Vatikan, 12 Prill, 2020

Sot në të gjithë botën besimtarët katolik festojnë Pashkët. Por këtë vit ato janë ndryshe jo si gjithmonë, besimtarët nuk patën mundësi që të shkonin në kisha për shkak të pandemisë së koronavirusi, Covid 19.

Mesha e përvitshme e Papa Françeskut në Bazilikatën e Shën Pjetrit është ndjekur online ose nga televizori, d.t.th. pa prezencën fizike të popullit. Për herë të parë sheshi Shën Pjetër që çdo vit për Pashkë është plot këtë vit mbizotëronte qetësia.

Por Papa Françesku me fjalët e tij të ëmbla plot shpresë e dashuri ka kujtuar së Zoti nuk e harron njerëzimin i cili në këto kohë po përballet me një vështirësi të madhe siç është koronavirusi.

“Ne nuk dorëzohemi. Nuk vendosim gur mbi shpresën. ne mund dhe duhet të shpresojnë sepse Zoti nuk na ka lënë vetëm. Gjithçka do të shkojë mirë, e themi me këmbëngulje edhe shpresa më e guximshme mund të avullojë. Por shpresa e Jezusit është e ndryshe. Zoti është më i madh. Vdekja dhe errësira ende nuk e kanë thënë fjalën e fundit.

Varri është vendi ku hyn dhe nuk del dot më por Jezusi ia doli të dalë , ia doli për ne për të sjellë jetë atje ku ka vdekje. Për të filluar një histori të re, atje ku ishte vendosur një gur mbi të”- ka thënë Papa Françesku duke i uruar të gjithë besimtarët katolik në të gjithë botën Gëzuar Pashkët.





Mons. Angelo Massafra SHPRESOJMË ME BESIM NË HYJIN,	4
R.SH. Vatikan PAPA FRANÇESKU: TREDITSHI I PASHKËS	6
R.SH. Vatikan PAPA FRANÇESKU: URBI ET ORBI	8
Moter Marjeta Gjoka TA PREKUM FJALËN	10
Konferenca Ipeshkvore Shqipërisë DEKRET COVID-19	11
Konferenca Ipeshkvore Shqipërisë ZOTI MUND TË NXJERRË DIÇKA TË MIRË NGA NJË PËRVOJË E KEQE	12
Don Anton UKA CORONAVIRUSI ZBULON TË VËRTETËN	14
Don Nosh GJOLAJ NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE	18
Antonio Spadaro S.I.- Paul Twomey NJË SFIDË PËR KISHËN	21
Mons. Angelo Massafra NXËNËSIT PRESIN NGA EDUKUESIT	25
Jolanda Marena EJANI TEK UNË TË GJITHË	26
Mons. Angelo Massafra DOM MICHELANGELO BRAGA	26
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIII, nr. 3/4 (529-530) Mars - Prill 2020

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

**SHPRESOJMË ME BESIM NË HYJIN,
PËR NJË TË ARDHME TË NDRYSHME!**

KRISHTI U NGJALL, ALELUJA!



Të dashur vëllezër e motra,
erdhi edhe festa e Pashkës së Ngjalljes që, si kurrë ndonjëherë këtë vit, na bën thirrje me forcë për ta shprehur fenë tonë në Zotin e Kryqëzuar dhe të Ngjallur. Dhe, si kurrë ndonjëherë këtë vit, ndiejmë se sa të vërteta janë fjalët e Apostullit: “E në qoftë se vdiqëm bashkë me Krishtin, besojmë se edhe do të jetojmë bashkë me Të, pasi e dimë se Krishti i ngjallur nga të vdekurit, nuk vdes më: vdekja nuk ka më pushtet mbi Të” (Rom 6, 8-9).

Është e vërtetë, Apostulli i referohet lindjes së të krishterit në jetën e re, i lirë prej mëkatit, nëpërmjet fesë në ngjalljen e Krishtit, që të gjithë i shtyn që ta largojnë të keqen prej vetes së tyre dhe të vishen me dritën e të Ngjallurit. Por, nga një pikëpamje më materiale dhe lidhur me situatën dramatike që bota është duke përjetuar për shkak të pandemisë COVID-19, të ripërtërish fenë në të Ngjallurin do të thotë edhe të besosh në fitoren e Tij mbi vdekjen.

Në fakt, ky virus i rrezikshëm ka mbjellë viktimë të shumta që, me dashurinë e krishterë, ia kemi paraqitur zemërdhembshurisë së Hyjit në kremtimin e përditshëm Eukaristik, edhe pse pa pjesëmarrjen aktive të besimtarëve; në lutjen personale dhe, siç ka ndodhur edhe tjetërkund, me praninë guximtare të meshtarëve te koka e atyre që po përfundonin shtegtimin e tyre tokësor, duke u sëmure dhe duke vdekur edhe ata vetë.

Kjo Kreshmë e dhimbshme dhe ritet “e zhveshura” të Javës së Madhe na kanë bindur se Krishti nuk na shpëton “prej vdekjes”, por

“nëpërmjet” vdekjes, atë të Tijës para së gjithash: solidar me ne deri në fund, ka marrë pranë vetes jo vetëm jetën tonë, por edhe vdekjen tonë, dhe i ka dhënë asaj një vlerë të re, atë të ngjalljes. Jezusi na ka thënë: “Nëse kokrra e grurit e mbjellë në dhe nuk vdes, mbetet e vetme; po nëse vdes jep shumë fryt!” (Gjn 12, 24). Ai është fara e grurit, ajo farë që ka si qëllim të shumëzohet dhe të lulëzojë! E bashkë me Të edhe ata që kanë “rënë në tokë” dhe kanë vdekur.

Pra, vdekja nuk e ka fjalën e fundit mbi jetën, por është jeta që, duke u ngjallur, e gëlltit vdekjen për ta asgjësuar për amshim. Dhe ja që, si i krishterë, feja në Ngjallje na hap ndaj virtutit tjetër teologal, atë të shpresës. Shën Pali na përsërit: “Ne mburremi edhe për vuajtjet, sepse e dimë mirë se vuajtja sjell qëndresën, qëndresa na bën besnikë të sprovuar e besnikëria e sprovuar sjell shpresën, e shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona me anë të Shpirtit Shenjt që na u dhurua” (Rom 5, 3-5).

Për çfarë shprese na thërret Apostulli? Me siguri atë të lavdisë së Hyjit (krh. rr. 2), lavdi që, siç na mëson Shën Gjoni në Ungjillin e tij, ka të bëjë me të mirën e njerëzimit të dashur prej Tij: e kemi dëgjuar të dielën e katërt të Kreshmëve, në lidhje me të verbërin e lindur, dhe të dielën e pestë të Kreshmëve, në lidhje me ringjalljen e Lazrit. Pra, shpresojmë me besim se Hyji ka ruajtur për ne një të ardhme të ndryshme prej skenarëve të vdekjes me të cilat jemi mësuar këto kohët e fundit.

“Sepse dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona



me anë të Shpirtit Shenjt që na u dhurua”. Por nuk mjaftojnë vetëm feja dhe shpresa: virtyti tjetër teologal që na kujton Ngjallja është ai i dashurisë, e vetmja prej të trijave që vazhdon edhe pasi të kalojë kjo jetë tokësore. Dhe kur kësaj pandemie t’i vijë fundi çfarë fryti do të marrim, nëse jo atë të mirë që kemi mbjellë gjatë kësaj kohe? Dhe e mira është gjithnjë e vetëm rezultat i dashurisë.

Si të krishterë që jemi, e dimë se kemi marrë si dhuratë Shpirtin e të Ngjallurit. Për virtyt të kësaj Dashurie të Atit dhe të Birit, edhe ne jemi të aftë të duam dhe për këtë arsye “mos të duam me fjalë e me gjuhë, por me vepra e në të vërtetë” (1Gjn 3, 18).

Këtë solidaritet që Krishti ka treguar ndaj nesh është koha që ta vëmë në praktikë: duke pasur respekt për veten, para së gjithash, pasi të afërmin mund ta duam vetëm nëse duam veten tonë (kështu na mëson Jezusi!), duke dhuruar atë që është e mirë dhe e drejtë, duke respektuar rregullat e vëna për të mirën e shëndetit tonë dhe të tjerëve; duke i bërë thirrje aftësisë sonë krijuese për t’i jetuar mirë marrëdhëniet tona, sidomos tani që jemi të detyruar të jetojmë 24 orë në 24 me njëri-tjetrin; duke përfutur prej kësaj kohe mungese të detyruar aktiviteti mund ta njohim më mirë njëri-tjetrin, mund të mësojmë artin e durimit bërë për dashuri, mund të zbulojmë te ai që është përkrah nesh aftësi e veçanti që deri tani nuk kemi pasur mundësi t’i njohim.

Kështu, edhe ne do të ngjallemi së bashku me Krishtin: në fe, si ajo e atij që mbjell, duke ditur se ajo farë do të mbijë; në shpresë që, edhe mes

vështirësish, ai filiz do të bëhet një pemë; në dashurinë që mbush zemrën, duke parë frytet që, prej asaj peme, do të varen bollëkshëm për t’i dhënë ngjyra tryezave tona të përgatitura për festë.

Sot është kjo festë dhe kjo tryezë e përgatitur! Në qiell për ata që, të gjetur vigjilentë në tokë, Ati do t’i ulë në tryezë dhe do t’u shërbejë Ai vetë (Lk 12, 37); dhe këtu në tokë për ne që atë tryezë e përgatisim në shtëpitë tonë dhe në altaret e kishave tona si simbol të banketit të amshuar të cilin me aq zjarr e dëshirojmë.

Guxim, pra, vëllezër e motra. Të mos shkurajohemi, por ta lëmë zemrën tonë që të ngrohet prej dritës së të Ngjallurit. Ai na thotë, si në këngën e hyrjes së Meshës së Pashkës: “Jam ngjallur, jam gjithmonë me ty; Ti e ke vënë dorën tënde mbi mua, është e mrekullueshme për mua urtia Jote. Alleluia”.

Edhe ne, së bashku me Krishtin, i themi Atit, në fe: “Jam ngjallur, jam gjithmonë me ty!” dhe asgjë nuk do të na ndajë prej Teje dhe prej dashurisë Sate të pafund, që, edhe pse ia lejon vdekjes që të na prishë lumturinë, nuk mund të mos nxjerrë të mirën prej të keqes dhe dritën prej natës më të errët.

Urime të gjithëve ju, vëllezër e motra në Krishtin. I Ngjalluri ju mbushtë me bekimin e Tij dhe ju bëftë të provoni dashurinë e Atit nëpërmjet Shpirtit, që është Zot dhe që jep jetë. Amen.

Urime të singërta!

† Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkvi juaj

FRANÇESKU: TREDITSHI I PASHKËS, NDËRMJET KRYQIT TË KRISHTIT E UNGJILLIT

Në audiencën e sotme të përgjithshme, nga Biblioteka Apostolike, Papa Françesku i ftoi besimtarët t'i jetojnë Mundimet dhe vdekjen e Krishtit si "liturgji e madhe shtëpiake", me sytë ngulur mbi kryqin e Krishtit e duke medituuar fjalët e Ungjillit. R. SH. – Vatikan, 3 prill 2020.

"Liturgjia shpëpiake" në triditshin e Pashkëve, do të kremtohet me dy gjeste: duke shikuar Krishtin e kryqëzuar e duke lexuar Ungjillin. Në këtë mënyrë, sipas porosisë së Papës, duhet t'i jetojmë çastet më prekëse para Pashkëve, në një kohë të vështirë të historisë, që i ngjet Udhës së Kryqit. Kohë, në të cilën lindin shumë pikëpyetje. E disa prej tyre - pohon Papa - kanë të bëjnë edhe me Zotin. Françesku i kujtoi kështu, këto pyetje tronditëse: "Ç'po bën Zoti përballë dhimbjes sonë? Ku është, kur gjithçka shkon zi e më zi? Pse nuk i zgjidh menjëherë problemet?". Për të shtuar, më pas, se pikërisht tregimi i Mundimeve të Krishtit na ndihmon t'u japim përgjigjen e duhur.

Centurioni zbulon fytyrën e vërtetë të Zotit

Edhe njerëzit që e rrethonin Krishtin, kishin shumë pyetje lidhur me të. Pyesnin njerëzia: "Thua vërtet do ta shpëtojë popullin nga armiqtë e tij?" Jezusi nuk ua mbushte syrin, nuk u përgjigjej shpresave të tyre. Ata prisnin një Mesi të plotfuqishëm e ngadhënjyes, me shpatë të zhveshur. Ndërsa shikojnë një njeri zemërburë e të

përvujtë, që u bën thirrje për shndërrimin e zemrave e për mëshirë. E kur e shikojnë, pastaj, të mbërthyer mbi kryq, ikin të gjithë. E braktisin, duke menduar se ky Krisht nuk mund të ishte Mesia. E Françesku vijoi:

"Por nëse do të shkojmë më tej e do të lexojmë tregimin e Mundimeve, do të gjejmë një fakt mahnitës. Kur Jezusi vdes, centurioni romak – i cili nuk ishte besimtar, nuk ishte as hebre e as pagan - e pa duke vdekur mbi Kryq, e dëgjoi duke i falur të gjithë, e preku me dorë dashurinë e tij të pamasë, thotë. 'Vërtet ky njeri ishte i Bitri i Zotit'".

Kryqi është katedra e Zotit

Centurioni flet krejt ndryshe nga të tjerët. Po cila është vërtet fytyra e Zotit? Në Të - pohon Papa - ne projektojmë vetveten, ashtu si jemi në kulmin e forcës, po Zoti është ndryshe. Erdhi mes nesh, që ta njohin të gjithë e pikërisht për Pashkë na u dëftua plotësisht:

"E ku u dëftua plotësisht? Mbi kryq. Atje e shohim fytyrën e vërtetë të Zotit. Nuk duhet harruar, vëllezër e motra, se kryqi është katedra e





Zotit. Na bën mirë të rrimë e ta shikojmë Kryqin në heshtje e të shikojmë kush është Zoti ynë: është ai, që nuk e drejton gishtin kundër askujt, por ua hap krahët të gjithëve, deri atij, që po e kryqëzon; është ai, që nuk mburret me lavdinë e tij, por zhvishet i tëri për ne; ai, që nuk do fjalë, por jep jetën në heshtje”.

Prandaj e shikojmë Krishtin e kryqëzuar, për t'u çliruar nga paragjykimet për Zotin - kujtoi Papa - duke na porositur, pastaj, ta hapim edhe Ungjillin:

“Në këto ditë, të gjithë në karantinë e në shtëpi, të mbyllur, t'i marrim këto dy gjëra në dorë: të shikojmë Kryqin e ta hapim Ungjillin. Kjo do të jetë për ne si një liturgji e madhe shtëpiake, sepse nuk mund të shikojmë në Kishë këto ditë. Kryqin e Ungjillin!”.

Është e nevojshme - vijoi më tej Françesku - ta shikojmë Krishtin e Kryqëzuar, për ta kuptuar. Por është e mira ta hapim edhe Ungjillin. Aty lexojmë se kur njerëzit deshën ta shpallnin mbret, a kur djajtë deshën ta zbulonin natyrën e tij hyjnore, Jezusi nuk deshi. Pse?

“Sepse nuk deshi të keqkuptohej, nuk deshi që njerëzit ta ngatërronin Zotin e vërtetë, që është dashuri e përvujtëri, me zotin e rremë, zot sipas mendësisë së botës, që jep shfaqje e imponohet me forcë”.

Identiteti i vërtetë i Jezusit zbulohet në fjalët e centurionit. Në atë çast shikojmë se Zoti është i gjithëpushtetshëm në dashuri, e në asnjë mënyrë tjetër.

Zoti, i gjithëpushtetshëm në dashuri

Natyra e Zotit është dashuri - vijoi Françesku - po

shumëkush do të mund të thoshte se nuk u duhet gjë një Zot kaq i ligshët. Duke harruar se pushteti i kësaj bote kalon, ndërsa dashuria mbetet:

“Është dashuria e Zotit ajo, që me Pashkët e Tij, e shëroi mëkatin tonë; me fjalën e Tij, e bëri vdekjen jetë; e shndërroi frikën tonë në besim, ankthin, në shpresë. Pashkët na thonë se Zoti mund ta shndërrojë gjithçka të keqe, në të mirë. E ky nuk është iluzion, sepse vdekja dhe ngjallja e Jezusit nuk është iluzion: ishte e është e vërtetë. Ja pra, pse në mëngjesin e Pashkëve thuhet: 'Mos kini frikë!'”.

Nuk jemi vetëm, Zoti nuk na harron

Ashtu si Jezusi e ndërroi historinë: “duke u bërë i afërt me ne”, e me vdekjen e tij e mendi vdekjen, kështu edhe ne “mund t'i ndërrojmë historitë tona, duke iu afruar Atij”.

T'i'a ngulim, pra sytë, Kryqit, e do të kuptojmë se nuk jemi vetëm, se Zoti na do, se Zoti nuk na braktis e nuk na harron, kurrë!

Me këto mendime Papa Françesku u uroi të gjithëve Javë të Madhe e Pashkë të shenjtë.

Urimi studentëve të impenjuar në takimin Universitet 2020.

Gjatë përshëndetjeve, në përfundim të katekizmit, Papa kujtoi grupet, që do të kishin dashur të ishin të pranishëm në audiencën e sotme. Ndërmjet tyre, universitarët nga vende të ndryshme, që po e jetojnë simbolikisht takimin UNIV 2020”. Java e Madhe - i uroi - qoftë rast për ta fuqizuar lidhjen tuaj personale me Jezusin e besimin tuaj në Zotin e kryqëzuar e të ngjallur”.

URBI ET ORBI. PAPA: NUK ËSHTË KOHA E EGOIZMIT, E PËRÇARJES, POR E SOLIDARITETIT

Pas Meshës Shenjte, Françesku dha bekimin e ditës së Pashkëve. Në mesazhin drejtuar Romës e Botës kërkoi përsëri armëpushimin global dhe ndalimin e menjëhershëm të fabrikimit të armëve. Duke iu lutur Krishtit të ngjallur, kujtoi krizën shëndetësore dhe një mori emergjencash të harruara. R. SH. – Vatikan, 12 prill 2020.



Pas Meshës Shenjte, Françesku dha bekimin apostolik të Ditës së Pashkëve të Krishtit. Në mesazhin drejtuar Urbi et Obr – Romës e Botës kërkoi përsëri armëpushimin global dhe ndalimin e menjëhershëm të fabrikimit të armëve. Duke iu lutur Krishtit të ngjallur, kujtoi krizën shëndetësore dhe një mori emergjencash të harruara. Më poshtë, mesazhi i Françeskut drejtuar Romës dhe botës:

“Sot jehon në mbarë botën kumti i Kishës: “Jezusi u ngjall!- “Vërtet u ngjall!”.

Si një flakë e re ky Lajm i Mirë flakëroi nëpër natë; natë e një bote, prej kohe e zënë me sfidat epokale e tani e shtypur nën barrën e pandemisë, që po e vë në provë të rëndë familjen njerëzore. Në këtë natë ri jehoi rishtas zëri i Kishës: “Krishti, shpresa ime, u ngjall!” (Sekuenca e Pashkëve).

Është një “pandemi” tjetër, kjo, që “ngjitet” nga zemra në zemër – sepse çdo zemër njerëzore e pret

këtë Lajm të Mirë. Pandemia e shpresës: “Krishti, shpresa ime, u ngjall!”. Nuk është formulë magjike, që i bën të zhduken problemet. Jo, kjo nuk është ngjallja e Krishtit! Ngjallja e Krishtit është fitorja e dashurisë mbi rrënjën e së keqes, fitore, që nuk i “lë pas” vuajtjen e vdekjen, por i kapërcen, duke marrë rrugën drejt honit e duke e shndërruar të keqen në të mirë: vulë, që e ka vetëm pushteti i Zotit!

I Ngjalluri është i Kryqëzuari, askush tjetër. Në korpën e Tij të lumnueshëm mbart plagët e pashlyeshme: plagë që bëhen frëngji shprese. Kah Ai i drejtojmë sytë tonë, duke iu lutur t'i shërojë varrët e njerëzimit të plagosur.

Sot mendimi im shkon posaçërisht tek ata, që u goditën drejtpërdrejt nga koronavirusi: tek të sëmurët, ata që vdiqën e familjarët, që qajnë për humbjen e të dashurve, të cilëve shpesh nuk arritën as t'u japin lamtumirën e fundit. Zoti i jetës i marrtë për dore të vdekurit në mbretërinë e tij; i dhashtë ngushëllim e shpresë atij, që vijon të jetë në provë, posaçërisht pleqve dhe njerëzve të vetmuar! Premtoftë të mos u mungojnë ngushëllimi i Tij e as ndihmat e nevojshme njerëzve, që jetojnë në kushte vështirësish të veçanta, si atyre që punojnë ndër spitale, ose që jetojnë në kazerma e ndër burgje! Për shumëkënd janë Pashkë vetmie, të jetuara në zinë e mjerimin, që po shkakton pandemia, duke nisur nga vuajtjet fizike, tek problemet ekonomike.

Kjo sëmundje ngjitëse na la jo vetëm pa ngrohtësinë njerëzore, por edhe pa mundësinë që ta ndjejmë personalisht ngushëllimin, i cili gurrin nga Sakramentet, posaçërisht nga Eukaristia e nga Sakramenti i Pajtimt. Në shumë vende nuk ka qenë e mundur të merren, po Zoti nuk na la vetëm! Duke mbetur të bashkuar në lutje, jemi të sigurt se Ai na e mban dorën mbi krye (krh Ps. 138,5), e na përsërit me forcë: mos ki frikë! U ngjalla e jam përgjithmonë me ty!” (krh Meshari Romak)

Jezusi, Pashka jonë, u dhashë forcë e shpresë mjekëve e infermierëve, që po japin kudo dëshmi kujdesi e dashurie ndaj të afërmit, deri në shterrimin e forcave e, jo rrallë, edhe me flijimin e shëndetit! Tek ata, ashtu si edhe tek njerëzit e tjerë, që punojnë me zell për të garantuar shërbimet kryesore, të nevojshme për bashkëjetesën civile,

tek forcat e rendit e tek ushtarakët, që në shumë vende dhanë ndihmesën e tyre për t'i lehtësuar vështirësitë e vuajtjet e popullsisë, shkon mendimi ynë e mirënjohja jonë.

Në këto javë, jeta e miliona njerëzve ndryshoi krejt papritur. Për shumë, ngujimi në shtëpi ishte rast për të reflektuar, për t'i ndalur ritmet e ethshme të jetës, për të ndenjur me të dashurit e për të shijuar shoqërinë e tyre. Për shumë të tjerë është edhe kohë shqetësimi për ardhmërinë, e cila duket krejt e paqartë; për punën, që rrezikohen ta humbasin e për pasojat e tjera, që sjell kriza. Inkurajoj ata që kanë përgjegjësi politike të bëjnë çmos në favor të së mirës së përbashkët të qytetarëve, duke u siguruar mjetet dhe instrumentet e nevojshme, që u krijojnë të gjithëve mundësinë të kalojnë një jetë dinjitoze e të favorizojnë, kur e lejojnë rrethanat, rifillimin e veprimtarive të përditshme.

Nuk është kjo koha e indiferencës, sepse mbarë bota po vuan e duhet ta ndjejë veten të bashkuar në përballimin e pandemisë. Krishti i ngjallur u dhashë shpresë gjithë të varfërve, atyre që jetojnë në periferi, refugjatëve e të pastrehëve! Nuk duhen lënë vetëm këta vëllezër e motra më të lagësht, që popullojnë qytetet dhe periferitë në të katër anët e botës. Të mos lejojmë t'u mungojnë gjërat më të nevojshme, që gjinden me vështirësi tani, kur shumë veprimtari janë të mbyllura; ashtu si dhe ilaçet e, sidomos, mundësia për asistencën e duhur shëndetësore. Duke pasur parasysh rrethanat, u lehtësofshin dhe masat ndëshkimore ndërkombëtare, të cilat i frenojnë mundësitë e vendeve të ndëshkuara për t'u dhënë mbështetjen e duhur qytetarëve të tyre e për t'u krijuar të gjitha shteteve, posaçërisht më të varfrave, kushtet për t'i bërë ballë nevojave më të mëdha të çastit, duke ua reduktuar, nëse nuk mund t'ua falin, borxhin që rëndon mbi buxhetet e tyre.

Nuk është kjo, koha e egoizmave, sepse sfida që po përballojmë na bashkon të gjithëve e nuk bën dallime ndërmjet njerëzve. Ndërmjet të gjitha zonave të botës, të prekura nga koronavirusi, i drejtoj një mendim të veçantë Evropës. Pas Luftës II Botërore, ky kontinent i dashur mundi të rilindë falë frymës konkrete të solidaritetit, që e ndihmoi t'i kapërcejë rivalitetet e së kaluarës. Është më urgjente se kurrë, posaçërisht në rrethanat e sotme, që këto rivalitete të mos e ngrenë më kokën, por të gjithë ta kuptojnë se janë pjesë e një familjeje të vetme e ta mbështesin njëri-tjetrin. Sot Bashkimi Evropian është përballë një sfide epokale, nga e cila varet jo vetëm ardhmëria tij, por edhe ajo e mbarë botës. Nuk duhet humbur rasti për të dhënë një provë solidariteti, edhe duke kërkuar rrugëzgjdhje

të reja. Alternativa është vetëm egoizmi i interesave të veçanta dhe tundimi i rikthimit të së kaluarës, me rrezikun e vënies në provë të rëndë të bashkëjetesës paqësore dhe të zhvillimit të brezit të reja.

Nuk është kjo, koha e përçarjeve. Krishti, paqja jonë, i shndritet ata, të cilët kanë përgjegjësi në konfliktet, të marrin guximin e t'i përgjigjen thirrjes për armëpushimin global e të menjëhershëm në të katër anët e botës! Nuk është kjo, kohë për fabrikimin dhe trafikun e armëve, kohë për të shpenzuar kapitale shumë të mëdha, që do të duhej të përdoshin për të mjekuar njerëzit e për të shpëtuar jetë. Është, ndërkaq, koha për t'i dhënë fund luftës së pafundme, që gjakosi Sirinë, konfliktit në Jemen e tensioneve në Irak, ashtu si edhe në Liban. Qoftë kjo, koha e rifillimit të dialogut ndërmjet Izraelitëve e Palestinezëve, për të gjetur një rrugëzgjdhje të qëndrueshme, afatgjatë, që u krijon të dyja palëve kushtet për të jetuar në paqe! Përfundofshin vuajtjet e popullsisë, që jeton në zonat lindore të Ukrainës dhe sulmet terroriste kryer kundër një mori njerëzish në vendet e Afrikës.

Nuk është kjo koha e harresës! Kriza, që po përballojmë, mos na bëftë të harrojmë një mori emergjencash të tjera, që sjellin me vete vuajtje të rënda për shumë njerëz! Zoti i jetës qoftë pranë popullsisë të Azisë e të Afrikës, që po kalojnë kohë krizash humanitare, ashtu si edhe në rajonin e Kabo Delgado, në veri të Mozambikut! Ua ngrohtë zemrën refugjatëve e të shpërngulurve të shumtë, për shkak të luftërave, të thatësirës e të zisë së bukës. I mbrojtët migrantët dhe refugjatët e panumërt, shumë prej të cilëve janë fëmijë, që jetojnë në kushte të padrueshme, posaçërisht në Libi e në kufirin ndërmjet Greqisë e Turqisë! Premtoftë që në Venezuelë të gjinden rrugëzgjdhje konkrete e të menjëhershme, të cilat synojnë të pranohet kërkesa për ndihmë ndërkombëtare ndaj popullsisë, që vuan nga shkak i krizës së rëndë të koniukturës politike, shoqërore-ekonomike e shëndetësore.

Të dashur vëllezër e motra, indiferenca, egoizmi, harresa nuk janë fjalët që dëshirojmë t'i dëgjojmë në këtë kohë. Madje duam t'i zhdukim nga të gjitha kohët! Ata duket sikur mbizotërojnë, kur në shpirtin tonë jetojnë frika e vdekja, domethënë, kur nuk e lëmë të fitojë Zotin Jezus në zemrën tonë e në jetën tonë. Ai, që e mundi vdekjen duke na hapur udhën e shëlbimit të amshuar, i davaritët terrinat e natyrës sonë njerëzore e na priftë në ditën e lume, që nuk njeh perëndim!



Moter Marjeta GJOKA

TA PREKUM FJALËN E CILA ËSHTË ZËRI I SHPIRTIT

Prandaj, nuk e humbim guximin, por, nëse njeriu ynë i jashtëm shkon duke u shkatërruar, njeriu i brendshëm dita - ditës përtërihet” (2Kor 4, 16).

Duke ju referuar fjalës së Zotit secili lexues që dëshiron ta shfletojë Shkrimin Shenjtë i duhet të krijojë një mënyrë heshtje përpara Shkrimit, nëse dëshiron të hyjë në thellësi të saj. Shumë herë lexuesi gjendet si i verbër përballë fjalëve që ai shfleton në brendësi, e shikon vetën në errësirë. Kjo gjendje e detyron lexuesin të kërkojë një mënyrë që të kuptojë thelbin e çdo fjalë për një kohë të gjatë, derisa fjala që ai lexon e prekë thellë në zemër dhe e ndihmon që të rifillojë dhe të rimarrë një udhëtim të duhur. Siç kanë bërë edhe dishepujt e Emausit, kur e kuptuan që i ngjalluri ishte me ta u hap mendja e tyre (Krh. Lk 24, 31). Po ashtu nëse kujtojmë gruan plot fe që lexojmë në brendësi të Shkrimit Shenjtë, e cila merr guximin dhe i prekë mantelin Jezusit dhe po në atë moment shërohet nga sëmundja që ajo kishte (Krh. Lk 8, 44-46). Në krahasim me atë çfarë po vë në dukje, në të vërtetë kemi nevojë edhe ne të prekim Jezusin, ta prekum fjalën Tij dhe ta lëmë atë që të na shndërrojë nën tonë, nga ato sëmundjet e përditshme që nuk na lejojnë të shohim dritë, por ecim në errësirë si të verbër, këtë na rikujton edhe Isaia që na thotë kështu: “Ecim duke prekur si të verbër murin, si ata që sy s'kanë ecim me hamendje; marrim në thua në mesditë, porsë në mug, [...]” (Is 59, 10). Është e nevojshme që më përvujtëri të pohojmë se zemra jonë nuk është e pastër dhe sytë tanë nuk janë ashtu siç duhet të jenë sytë e nuses së bukur të Krishtit, për të cilën dhëndri i thotë: “e bukur je, mikesha ime, oh sa e bukur: sytë e tu sy pëllumbeshë” (Kk 1, 15). Në të vërtetë jemi të vetëdijshëm për gjendjen tonë që nuk i përngjajmë pëllumbeshës, por kjo nuk duhet të na shkurajojë, përkundrazi, sepse çdo ditë duhet të jetë për ne një mundësi rifillimi për të jetuar si bijë të Hyjit, duhet të jetë një mundësi që të hyjmë në vetvete dhe ti referohemi fjalës së Hyjit dhe të lihem i prekemi nga hiri i Tij, këtë mundemi ta bëjmë vetëm kur ne besohemi. Metafora e prekjes ka domethënie që ne hyjmë në një relacion me realitetin Hyjnor, dhe në këtë rast flasim për një (risi), për një ndryshim të qenies tonë, mundemi të përdorim fjalën metanoia që vjen nga greqishtja «μετάνοια-μετανοία» që do të thotë kthim ose ndryshim në mënyrën tonë e të menduarit, të shikuarit dhe të jetuarit, sepse jemi prekur nga fjala e Jetës që është vetë Krishti. E në këtë rast nuk na mbetet tjetër veçse ta dëshmojmë siç na fton edhe Shkrimi Shenjtë, që thotë: “Çka ishte qysh në fillim, çka dëgjuam, çka pamë me sytë tanë, çka soditem dhe duart tona prekën, në lidhje me Fjalën e jetës, po, jeta u shfaq, ne e pamë dhe dëshmojmë [...]” (1Gjn1, 1-2). Takimi me Fjalën e Zotit na çon drejt një intimiteti dhe kjo ndodhë kur ne heshtim përpara sajë dhe dëgjojmë atë çfarë Shpirti Shenjtë dëshiron të na mësojë e mbi të gjitha dëshiron të na shndërrojë në krijesa të reja, që të ndodhë kjo na duhet të kemi «besim».

Siç na thotë Shën Pali në letrën e dytë të korintianëve “prandaj, nuk e humbim guximin, por, nëse njeriu ynë i jashtëm shkon duke u shkatërruar, njeriu i brendshëm dita - ditës përtërihet” (2Kor 4, 16). Në këtë Letër, Shën Pali na mëson një metodë, ai gjurmon një mënyrë për të gjithë ne. Jeta e përditshme përbëhet nga ngjarje të vogla, këto gjithashtu duhet të sillen në Krishtin, të lexohen në Krishtin, të ekzaminohen dhe të analizohen në Krishtin dhe të zgjidhen në Krishtin. Nëse misteri i Krishtit nuk përfaqëson veprimet tona më të vogla, vendimet, fjalët, sjelljen, nëse diçka nga ne mund të mbetet jashtë misterit të Krishtit, nëse mund të shpjegohet pa të, do të thotë që ai nuk është Shpëtimtari ynë, ai nuk është Shëlbuesi ynë, dhe ndryshueshmëria e vërtetë nuk vjen tek ne. Edhe Shën Pali na bën të kuptojmë që nuk është kështu sepse ai na thotë “mbasi jemi bashkëpunëtorë me Të, ne ju qortojmë: mos e lini pa fryt hirin që morët prej Hyjit! Ai thotë: Në kohë të volitshme të vështrova, në ditë të shpëtimit të ndihmova. Ja, pra tani koha e volitshme, ja, pra, dita e shpëtimit” (2Kor 6, 1-2). Por e vërteta është që, në ditë të sotme, pothuajse të gjitha problemet e jetës kërkojnë të zgjidhen pa dritën e Krishtit por kjo në të vërtetë kurrë nuk do jetë plotësisht e realizuar mbi të gjitha për ne të krishterët.

Sepse ftesa e bërë me gjithë zemër për çdo njeri është që ta mirëpresë Krishtin, që të lahet nga gjaku i tij, të pranojë hirin e tij, dhe të jetë banesë e Shpirtit Shenjtë, të hyjë në bashkësinë e të shpëtuarve dhe të shpëguarve, të fillojë një jetë të re, të shenjtë, e të gërshtuar me besim, shpresë e dashuri.

Dashuria e Krishtit, dëshiron që dishepulli i Tij të jetë i drejtë, të japë një dëshmi të krishterë, të jetë i pastër në zemër dhe i lirë nga mentaliteti i botës.

Dishepulli i Krishtit duhet të jetë një Ungjill i gjallë i Krishtit, ashtu si Krishti ishte Ungjilli i gjallë i Atit, ose më saktë Fjala mishëruese e Atit që erdhi të banojë midis nesh (Krh. Gjn 1, 1-5). Dishepulli i Krishtit duhet të jetë dëshmitar i FJALËS, e cila është bërë e dukshme në historinë e njerëzimit, e prekshme dhe vepruese, zgjidhja e problemeve shpirtërore të njeriut, vepër dashurie, mbi këtë shembull duhet të jetë çdo i krishterë i vërtetë.



**SITUATA PROBLEMATIKE E DITËVE TË FUNDIT
E KRIJUAR NGA COVID-19 NË SHQIPËRI**

KONFERENCA IPESHKVORE SHQIPËRISË

Prot.nr. 08/2020

DEKRET

Fort të dashur meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare, besimtarë,

Duke vlerësuar situatën e ditëve të fundit e krijuar nga Covid-19 në Shqipëri, duke pasur parasysh urdhëresën nr. 132, datë 08.03.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, po ashtu Letrën e Konferencës Ipeshkvore të datës 29 shkurt 2020, duke vlerësuar përvojën e kishave simotra në vende të tjera, pas konsultimit me specialistë të fushës e duke i thirrur sensit të përgjegjësisë si Ipeshkvij të Kishës Katolike në Shqipëri:

Dekretojmë:

- Pezullimin e të gjithë aktiviteteve dioqezane dhe famullitare në Kishën Katolike në Shqipëri në të cilat parashikohet pjesëmarrja dhe grumbullimi i popullit deri me datë 3 prill 2020 e që konkretisht do të thotë:

- Pezullimin e të gjitha kremtimeve liturgjike, përfshirë Meshën e Shenjtë;
- Pezullimin e katekizmit, për fëmijë e të rritur;
- Pezullimin e të gjitha aktiviteteve të tjera të programuara, dioqezane dhe famullitare, me fëmijët dhe të rriturit;
- Pezullimin e të gjitha kurseve të formimit pranë qendrave tona komunitare.

Ndërkohë, ftojme famullitarët që:

- të kremtojnë Meshën në kapelat e tyre, duke e transmetuar atë edhe online nëpërmjet rrjeteve sociale;
- të garantojnë rrëfimin personal duke ruajtur distancat e duhura e duke garantuar edhe sekretin e bisedës;
- të garantojnë marrjen e Kungimit për të sëmurët që e kërkojnë në shtëpi dhe për ata të pranishëm, gjithmonë duke ruajtur rregullat e vendosura nga organet e shëndetësisë;
- të garantohet Sakramenti i Vajimit për të sëmurët në rastet kur kërkohet, duke ndjekur rregullat e duhura higjienike;
- të garantohen funeralet duke shmangur mbledhjen e popullit, por duke bërë lutjen në momentin e mbylljes së arkivolit dhe në momentin e vendosjes në varr;
- kishat të rrinë të hapura për lutjen personale gjatë ditës, duke informuar dhe këshilluar njerëzit që të mbajnë distancën e duhur nga njëri-tjetri.

Po ashtu ftojme të gjithë besimtarët katolikë që të jenë të vëmendshëm dhe të dëgjueshëm ndaj rregullave dhe udhëzimeve të nxjerra nga organet përkatëse për përballimin e situatës.

Të jemi të vetëdijshëm për sakrificën që duhet të bëjmë të gjithë bashkë për të mirën e njerëzve dhe shëndetit të tyre.

Të vazhdojmë, të dashur besimtarë t'i lutemi Hyjit në familjet dhe në shtëpitë tona për këtë situatë që të kalojë sa më shpejt në vendin tonë dhe në të gjithë botën.

Ky dekret do të hyjë në fuqi nesër, e premte, 13 mars 2020.

Dhënë nga Selia e Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, me datë 12 mars 2020

Ipeshkvijtë e Kishës Katolike në Shqipëri

ZOTI MUND TË NXJERRË DIÇKA TË MIRË NGA NJË PËRVOJË E KEQE

***Ipeshkvijtë Katolike të Shqipërisë
falënderojnë e mbështesin meshtarët në
misionin e tyre gjatë covid-19***

*Në këtë kohë të pandemisë, kohë e vështirë për
mbarë njerëzimin, Ipeshkvijtë e Kishës katolike në
Shqipëri u drejtohen meshtarëve me një letër
falënderimi, afërsie, inkurajimi dhe nxitjeje për të
vazhduar me dëshminë e dashurisë së Zotit ndaj
çdo personi, “sepse jeni shpresë dhe një rreze drite
për shumë njerëz në këto ditë, jo vetëm në rrjetet
sociale, por edhe me anë të dëshmisë tuaj”. Në
vijim Letra e Konferencës Ipeshkvore Katolike të
Shqipërisë drejtuar klerit të vendit:*

Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë

Prot. Nr. 10/20

Tiranë, 23.03.2020

Të dashur meshtarë,

këto ditë të vështira për mbarë racën njerëzore,
për shkak të Covid-19, nuk kanë se si mos të prekim
edhe zemrat tuaja. Ne duam t'ju falënderojmë,
sepse jeni shpresë dhe një rreze drite për shumë
njerëz në këto ditë, jo vetëm në rrjetet sociale, por

edhe me anë të dëshmisë tuaj.

Meshtarët janë bashkëpunëtorët më të ngushtë të
urdhrit ipeshkvor dhe në këtë moment ne e ndjemë
fortë këtë të vërtetë. Ju po ndani bashkë me ne
peshën e udhëheqjes së grigjës së Hyjit në këtë orë
terri. Por feja jonë na thotë se ky terr e ka një cak. Në
Ungjillin e Lukës thuhet se territ e mbuloi tokën nga
mesdita deri në orën tre të pasdites (krh. Lk 23,44).
Hyji i ka vënë një cak territ e nuk mund të shkojë më
përtej. Ne nuk e dimë nga pikëpamja kohore këtë
cak e prandaj detyra jonë është të mbështesim me
fe, shpresë dhe dashuri popullin që Hyji na ka
besuar derisa ky terr të mbarojë.

Ju e dini tashmë se disa bashkëvëllezër tanë në
Itali kanë ndërruar jetë për shkak të Covid-19.
Duam të sjellim në vëmendje shembullin heroik të
don Giuseppe Berardelli të klerit të Bergamos i cili
ia dha aparaturën e tij të oksigjenit një më të riu se
vetja e tij. Vetë ai vdiq. Në kohë të tilla Hyji nxjerr
edhe shenjtër. Meshtarë të tjerë që kanë qenë mjekë
janë kthyer në korridoret e spitaleve për t'u shërbyer
pacientëve. E të gjithë ne të tjerët po mundohemi sa
më shumë t'u gjendemi pranë njerëzve tanë.

Në këto momente ndjejmë nevojën t'ju
drejtohem juve duke ju inkurajuar që të mos bini



pre e pesimizmit dhe e trishtimit. Edhe kur këto ndjenja zënë fole në zemrat tona, për shkaqe nganjëherë shumë reale, që na vijnë nëpërmjet lajmeve apo të njohurve tanë, të dimë të nxjerrim edhe nga ky moment të mirën dhe të bukurën. Në Shkrimin e Shenjtë historia e Jozefit, djalit të Jakobit, të shitur nga vëllezërit e tij, na tregon shumë mirë sesi Zoti mund të nxjerrë diçka të mirë nga një përvojë e keqe. Ja fjalët e Jozefit drejtuar vëllezërve të tij që e kishin shitur në Egjipt: “Mos kini frikë! Vallë, a mund t’i kundërshtojmë vullnetit të Hyjit? Ju njëmend ma menduat të keqen, por Hyji e ktheu atë në të mirë që të më lartësojë, si po shihni se ndodhi me të vërtetë, dhe për të shpëtuar një popull të madh. Mos druani! Unë do të kujdesem për ju dhe për fëmijët tuaj” (Zan. 50, 19-21).

Besimtarët tanë kanë nevojë të shohin tek ne pika referimi të forta, duan të shohin te ne sigurinë se Zoti nuk na braktis në asnjë moment. Kush më mirë se ju mund ta bëjë këtë gjë?

Prandaj kjo kohë na fton:

Së pari të bëjmë atë detyrë që kemi marrë me shugurimin tonë: *të lutemi për popullin e Hyji që na është besuar*, qoftë nëpërmjet Liturgjisë së Orëve, Meshës së shenjtë apo edhe *Lectio divina*. Është një kohë hiri në të cilën ne mund të ushqejmë jetën tonë shpirtërore. E ky ushqim shpirtëror do të na ndihmojë të shohim më thellë e *të shpresojmë kundër çdo shprese* (krh. Rom 4,18). Shpresa nuk lind një optimizëm naiv, por kurajë. Ja pse kemi shumë nevojë për shpresë në këtë situatë. Në lutjet tona te ftojmë edhe besimtarët tanë që në fëmijët apo në zemrat e tyre t’ju bashkohen edhe falë

mjeteve të komunikimit social. Përveç meshës, në mënyrë të veçantë t’ju kujtojmë Rruzaren e orës 21.00.

Së dyti të mos harrojmë të varfëritë. Ankthi i sëmundjes shoqërohet edhe me ankthin e pasigurisë ekonomike të shumë familjeve tona të varfër. Të angazhohemi në mënyrë që të varfërit tanë të ndjejnë dorën e butë të Hyjit provani nëpërmjet nesh. Mund të bashkëpunohet me shërbimet sociale të bashkive, ose ku nuk është e mundur, thjesht si bashkësi famullitare apo edhe ne si individë t’u gjendemi afër atyre që nuk kanë të hanë.

Së treti të rrisim e të forcojmë vllazërinë meshtarake duke iu gjendur njëri-tjetrit qoftë edhe me një telefonatë, një mesazh apo edhe duke ndrojtuar bashkë aty ku është e mundur.

Së katërti ju porosisim që për çdo shqetësim të na kontaktoni si etërit tuaj e ne do të jemi të gatshëm për t’ju përgjigjur e për të ndarë së bashku përgjegjësitë tona. Ne mirëpresim sugjerime nga ana juaj se si mund të veprojmë më mirë në këtë kohë të vështirë duke jetuar kolegialitetin kishtar i cili na ndihmon të marrim vendimet e duhura për të mirën e shpirtrave që na janë besuar.

Të dashur meshtarë! Ju falënderojmë për çfarë po bëni. Zoti jua shpërbleftë mundin dhe sakrificën. Ia besojmë jetën dhe shërbesën tuaj Marisë, Nënës së Këshillit të Mirë dhe Martirëve tanë. Qofshin ato shembull i besimit pa kushte në vullnetin e Hyjit.

Ipeshkvijtë tuaj



Don Anton UKA

CORONAVIRUSI ZBULON TË VËRTETËN E MADHE TË NJERIUT

Derisa po përballemi me Coronavirus, botën e ka kapluar frika dhe paniku për rrezikun që po e kanos shëndetin e trupit të njeriut. Ky angazhim dhe mobilizim i përbashkët – që është në harmoni të plotë me mësimin e krishterë – tregon vlerën që ka trupi ynë dhe përgjegjësinë që njeriu bart si për vetvetën ashtu edhe për të tjerët. Në situata të tilla krizash njeriu lehtë mund të mendojë se shëndeti i trupit është përcaktuesi i vetëm i jetës dhe i dinjitetit të njeriut.

Shkenca jep definicione të ndryshme në lidhje me këtë, ndërsa unë parapëlqej atë të Carlo Maria Martinin, i cili shëndetin e përkufizon si heshtje të trupit, nga e cila dilet kur sëmuremi, që d.m.th. në momentin që ndiejmë dhimbje fizike. Situata në të cilën gjendemi, na ka zgjuar nga heshtja, nga komoditeti dhe nga siguria se jemi të pamposhtur – duke parë arritjet dhe zhvillimet e mëdha shkencore, teknologjike dhe ekonomike – gjë që po rezultojnë e paafte për të siguruar harmoni dhe qetësi në jetën e qytetarëve.

Shëndeti, heshtja dhe sëmundja janë tri fjalë me një domethënie të thellë për vetë faktin se janë realitete, në të cilat kohë pas kohe apo në mënyrë të vazhdueshme jeton trupi i njeriut.

Çka është shëndeti i trupit? Shëndeti është gjendje mirëqenieje fizike dhe psikike për shkak të funksionimit perfekt të organizmit. Nga ky definicion kuptojmë se shëndeti është një e mirë e madhe që duhet ruajtur dhe mbrojtur, pikërisht për arsye se e lejon funksionimin e trupit, që domethënë e lejon njeriun të jetë aktiv dhe produktiv në punët dhe ndërmarrjet e tija fizike, intelektuale dhe shpirtërore. Shëndeti lejon marrëdhënien e mirë dhe koordinimin e plotë të gjymtyrëve mes vete. Dëmtimi i njërës zgjon nga heshtja gjymtyrët tjera, që do të thotë se sëmundja e njërës rrezikon infektimin apo sëmundjen edhe të tjetrës. Shëndeti lufton vazhdimisht për t'u vetëmbrojtur (antitrupe) nga çdo sulm që mundohet t'i

dëmtojë qelizat trupore. Më e madhja dhuratë, pas jetës, pa dyshim se është shëndeti apo harmonia trupore, psikologjike, shpirtërore dhe sociale e njeriut.

Çka është heshtja e trupit? Heshtja është sinonim i shëndetit apo e kundërta e zhurmës, e cila e lejon trupin e njeriut të funksionojë pa shqetësim, duke i dhënë atij qetësi, harmoni, paqe. Heshtja ia mundëson njeriut realizimin e kërkesave dhe dëshirave të thella të mendjes dhe zemrës. Ajo mundëson dëgjimin, kuptimin dhe ndërtimin e fjalës (jetës). Heshtja është ajo gjendje në të cilën ndodh njeriu në fillimin e kohërave; është marrëdhënie e njeriut me Hyjin, me të tjerët dhe me vetveten. Heshtja, duket mbyllje, por në realitet është hapje. Është shëndeti i shpirtit dhe i trupit, pa të cilën do të kishim zhurmë të papërballueshme (vdekjeprurëse). Heshtja është jeta e trupit.

Çka është sëmundja e trupit? E kundërta e shëndetit është sëmundja. Kjo do të thotë se sëmundja është dalje nga heshtja e trupit; pra, është zhurmë, dhimbje, çrregullim, panik, frikë. Sëmundja e trupit – për faktin se është kërcënim i shëndetit – që në pamundësi shërimi sjell vdekjen



(ndarjen nga trupi), detyrimisht përfshin pjesën psikologjike (ndjeshmërinë) dhe atë shpirtërore (shpresën) të njeriut. Në lidhje me këtë Carlo Maria Martini thoshte: “Sëmundja nuk është vetëm 'zhurmë e organeve trupore' – siç ka shkruar dikush – ; është edhe një zhurmë e mendimeve që më sulmojnë dhe torturojnë, duke dashur të më bindin se nuk jam më i dobishëm për askënd, nuk jam në gjendje të punojë, kam frikë se po bëhem barrë (ngarkesë) e të tjerëve, refuzoj të shërbehem nga të tjerët, të ndihmohem”. Sëmundja është dhimbje dhe dhembje (keqardhje) që shkakton “vetmi, vuajtje fizike dhe shpirtërore, nervozizëm, zhgënjim, dëshpërim, shqetësim, vështirësi komunikimi etj. Të gjitha këto dhurojnë një imazh mbi vetveten që më parë na ishte i panjohur” – theksonte Martini.

Sëmundja - vend ndarjeje

Duke qenë një e keqe në vetvete, sëmundja është e tillë edhe për të gjithë ata që në formë dhe mënyra të ndryshme janë të prekur prej saj. Megjithatë, duhet theksuar se ajo, nga aspekti shpirtëror dhe psikologjik, mund të ketë – dhe realisht ka – edhe anën e sajë pozitive, për faktin se e qon njeriun te thelbësorja, ia zbulon rrënjën e së keqes dëshpëruese, e provokon përbrenda duke e nxitur që të rishikojë atë për të cilën ka jetuar dhe jeton.

Trupi, “derisa është në gjendje të mirë shëndetësore, nuk ka nevojë të interpretohet” – thoshte kardinal Carlo Maria Martini. Pra, Martini e konsideron sëmundjen si vend ndarjeje, dhe nëse nuk kuptohet domethënia e saj, e ka fuqinë ta shkatërrojë njeriun, për faktin se ajo “mund të bëhet akuzuese, duke e fajësuar atë përmes pyetjeve: Çfarë të keqe kam bërë? Pse më ka ndodhur pikërisht mua?”

Përmes pyetjeve të tilla, personi i prekur nga sëmundja, e paraqet vetën si viktimë të një padrejtësie që papritur ka trokitur në derën e tij dhe pa leje është futur në shtëpinë (jetën) e tij. Arsytet e kësaj ndjeshmërie mund të jenë të ndryshme. Njëra ndër to mund të jetë se njeriu brenda vetes bartë dëshirën e pavdekshmërisë, nganjëherë duke harruar se pavdekshmëria e trupit është iluzioni më i madh që njeriu mund t'ia krijojë vetvetes.

Pse-të e ndryshme që njeriu mund t'ia shtrojë vetvetes në përvojën e sëmundjes, nga njëra anë mund të shndërrohen në një kërkim të Zotit apo në një përvojë të thellë shpirtërore, që vërtet mund të jetë ngushëlluese dhe shpresëdhënëse për pacientin dhe personat që merren me shërimin e tij dhe nga anën tjetër e kanë fuqinë të shndërrohen në një përvojë vetëfajësimi, e cila lehtësisht mund ta shpie atë drejt mbylljes në vetvete, që me kalimin e kohës

manifestohet përmes patologjive të ndryshme dhe shumë të rrezikshme për shëndetin e tij mendor. Me plot të drejtë Martini thoshte: “Në fakt vuajtja dhe sëmundja gjithmonë janë të vështira për t'u jetuar, por ato bëhen dyfishë më të vështira nëse nuk ia njohim domethënien, kuptimin”.

Kuptimi i vërtetë i sëmundjes dhe i vdekjes gjendet në personin e Jezu Krishtit, i cili me jetën (mrekullitë shëruese), mundimin (vuajtjen e pamerituar), vdekjen (humbjen e shëndetit) dhe ringjalljen e tij (kthimin e shëndetit në jetë) dëshmoi se ringjallja dhe jeta janë kryefjala e të gjitha sëmundjeve, vuajtjeve dhe vdekjeve të kësaj bote. Mjafton të besohet në premtimin e tij: “Unë jam Ringjallja dhe Jeta: kush beson në mua, edhe nëse vdes, do të jetojë. Edhe kush jeton e beson në mua, nuk do të vdesë kurrë” (Gjn 11, 25).

Sëmundja: përvojë serioze

Sëmundja është përvojë serioze jo vetëm për arsye se mund të sjell pasoja të paparashikueshme për jetën e njeriut, por edhe për faktin se ajo e detyron njeriun të ketë qasje ndryshe nga ajo kur ishte i shëndoshë, si ndaj vetvetes, ashtu edhe ndaj të tjerëve dhe botës në të cilën jeton. Kështu që në sëmundje personi është i detyruar të reflektojë mbi ekzistencën e vet e të rishikojë imazhin që kishte krijuar mbi vetveten në kohën në të cilën ishte në formë dhe shëndet të mirë.

Detyrimi apo obligimi, në pikëpamjen psikologjike, lehtë mund të shkaktojë ndjenja refuzimi dhe nervozizmi. Kështu që njeriu i prekur nga sëmundja detyrimisht hyn në konflikt me sëmundjen që papritur dhe pa pyetur e ka zgjuar nga heshtja trupin dhe mendjen e tij. Ky konflikt (refuzim) – duke qenë i vazhdueshëm dhe i paevitueshëm – dalëngadalë e detyron njeriun të merret me pyetjet ekzistenciale të jetës: Kush jam unë? Cili është qëllimi i jetës sime? Të jesh është një fat (bekim) apo një fatkeqë (mallkim)? Pse kam ardhur në këtë botë dhe ku shkoj pas vdekjes? A është më e logjikshme të besosh në jetën e përtëjshme apo të mos besosh? A është më mirë të jetosh vetëm apo me të tjerët?

Përmes këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave të ngjashme me këto, njeriu fillon të reflektojë seriozisht mbi ekzistencën e vet. Fillon të jetë i mbushur me mendime (reflektime) me të cilat ndoshta asnjëherë më parë nuk është ballafaquar. Nga këto reflektime fillon rishikimi i imazhit që ka krijuar mbi vetveten dhe pyetet: Çfarë kuptimi ka shëndeti, profesioni, puna, pasuria, familja, shoqëria, grumbullimi i të mirave? Çfarë kuptimi ka jeta, nëse fundi i saj është sëmundja dhe vdekja?

Këto pyetje e ndihmojnë personin të arrijë te e vërteta mbi vetveten: Unë jam i dobët, i pafuqishëm, i kufizuar. Unë kam nevojë për dikë që më ndihmon, më shëron, më ngushëllon. Unë kam nevojë, jo vetëm për medikamente (ilaqe) që mundohen ta shërojnë trupin, por edhe për një fjalë që e shëron shpirtin, mendjen dhe më ndihmon të shoh përtej situatës ekzistuese. Unë kam nevojë për Fjalën e mishëruar, për Zotin!

Në këtë qëndron serioziteti i sëmundjes, pikërisht për faktin se njeriu i sëmurë seriozisht (rëndë) e “eksperimenton ndryshe trupin e vet dhe thyeshmërinë (paaftësinë) e gjendjes njerëzore dhe mund të arrijë të vë në diskutim gjithçka duke u pyetur: çfarë kuptimi (vlere) ka të jetosh nëse pastaj duhet të vdesësh? – thoshte Martini.

Shërbëtori (trupi) rebelohet

Pandemia e shpallur me paraqitjen dhe përhapjen e shpejt të Coronavirusit dëshmon se sëmundja është diçka që prekë jo vetëm pjesën fizike (trupore) të njeriut, por – sidomos në ato raste që bëhet kërcënuese dhe vdekjeprurëse për trupin – ajo depërton në thellësinë e mendjes dhe të shpirtit. Kjo domethënë se sëmundja e ka një fuqi të heshtur, e cila është e aftë të përshkojë (prekë) tërësinë e njeriut: trupin, mendjen, shpirtin dhe marrëdhëniet e tija me të tjerët dhe me ambientin.

Sëmundja, në këndvështrimin martinjan, është

më shumë sesa diçka, ajo konsiderohet si një ngjarje, në të cilën njeriu vetëdijësohet për nevojat mbizotëruese dhe për britmat (rënkimet) e trupit, i cili ka qenë, deri në një pikë (kohë) të caktuar, shërbëtor i devotshëm, i heshtur dhe diskret.

Është shumë interesante dhe e veçantë kur Martini fliste për sëmundja si një ngjarje. Çka domethënë kjo? Çfarë ngjarje apo çfarë eventi është sëmundja?

Imazhi që Martini përdorë për ta përshkruar trupin e shëndoshë është ai i shërbëtorit të devotshëm. Pra, ky shërbëtor i devotshëm(trupi) apo gjithmonë i gatshëm që t'i plotësojë dhe t'i kënaq nevojat dhe kërkesat e mia, në momentin apo periudhën që ndjen sëmundjen rebelohet, zgjohehet nga gjumi, kërkon shërbimin, bëhet kërkues dhe shtron pyetjen: Çka është trupi im?

Pikërisht në momentin që trupi fillon të rebelohet, njeriu fillon të kuptojë se “përvojat jetësore, të cilat i supozonte instinktivisht si përvoja kënaqësie, posedimi dhe arritjeje, në një moment të caktuar manifestohen si përvoja privimi, pakënaqësie dhe dështimi” – thoshte Martini. Kur njeriu ndeshet më këtë përvojë fillon të kuptojë se nuk është pronar i vetvetes, nuk është pronar i trupit e as i fatit të tij. “Nuk jemi pronar as të mbarimit (përfundimit) tonë, sepse “trupi [...] i përket Zotin” (1 Kor 6, 13).

Zbulimi apo kuptimi se trupi nuk qenka pronë



absolute e njeriut, realisht ka dy rezultate: ose mund të shpie në dëshpërim dhe refuzim, për faktin e mospajtueshmërisë me një realitet të tillë, ose mund të shpie në ngushëllim dhe besim, për faktin se trupi i përket Hyjit, kështu që gjithçka është e Hyjit, është e çmueshme, e vlefshme, e shenjtë dhe e pavdekshme. Prandaj, edhe trupi i njeriut është i çmueshëm, i vlefshëm, i shenjtë dhe i krijuar për ngjalljen e lavdishme, që arrihet pikërisht përmes ngjalljes së trupit të Krishtit.

Sëmundja është pjesë e jetës

Nëse me fjalën apo shprehjen shëndet nënkuptojmë mirëqenien fizike, psikike, shpirtërore dhe sociale të personit, e cila i lejon atij të integrohet në ambientin e tij natyror dhe social, me fjalën sëmundje nënkuptojmë të kundërtën e shëndetit. Në këtë fjali, qëllimisht, kam sjellë tre emra: *Personi*, *shëndeti* dhe *sëmundja*, që realisht janë tri koncepte, jashtëzakonisht të thella, të cilat duhet t'i njohim, së paku në kuptimin e tyre të përgjithshëm, përndryshe nuk do të kuptonim njeriun, shëndetin e as sëmundjen e tij.

Tani, pa dëshiruar të futem në shpjegimin e thellë filozofik dhe teologjik të termit “Person”, por gjithmonë duke u mbështetur në të, mund të konstatoj se personi në tërësinë e tij është trup, shpirt, mendje dhe marrëdhënie sociale. Këto janë katër pjesët përbërëse të njeriut.

Trupi ia mundëson njeriut (personit) ekzistencën e tij historike dhe njëkohësisht e lejon atë të shpreh lidhjen apo marrëdhënien e tij me Krijuesin (Hyjin), me njerëzit tjerë dhe me natyrën. Njeriu, pikërisht duke u nisur nga trupi i vet, kupton jetën si një ngjarje që nuk vjen nga ai, por nga Dikush tjetër dhe realisht është e drejtuar drejt Tij (Hyjit). Pra, trupi në shëndetin dhe sëmundjen e tij paraqitet si vend-zbulim i Autorit të vërtetë të tij. Trupi ia mundëson njeriut ekzistencën e tij fizike si dhe realizimin e tij, edhe pse në këtë botë është gjithmonë realizim parcial.

Shpirti është fryma e Hyjit përbrenda njeriut, që ia mundëson atij marrëdhënien me Të. Kjo frymë e bënë apo e lartëson njeriun, secilin njeri, në imazh dhe në shëmbëllesë të Hyjit; e aftëson të dojë, të vihej në marrëdhënie me Të dhe të ketë pjesë në shenjtërinë e Tij.

Mendja si inteligjencë, kujtesë, vullnet, liri, përgjegjësi dhe përzemërsi e aftëson njeriun të kuptojë, të kujtojë, të zgjedhë, të vuajë, të gëzojë, të dhurojë dhe të pranojë dashuri. Pra, falë mendjes njeriu mundet apo aftësohet ta interpretojë jetën dhe ngjarjet e saja.

Dimensioni *social* i njeriut është dëshmi se personi është i integruar në kozmos dhe është në marrëdhënie të vazhdueshme me Hyjin, me të tjerët dhe më krijimin (natyrën).

Pasi që kemi shpjeguar termin “Person” dhe dimensionet e pazëvendësueshme të tij, kuptojmë se shëndeti është një gjendje e mirëqenies complete: fizike, mendore, shpirtërore dhe sociale, që do të thotë jo thjeshtë vetëm mungesë e sëmundjeve trupore apo fizike. Po ashtu kuptojmë se shëndeti është zgjatje drejt harmonisë fizike, psikike, shpirtërore dhe sociale e personit, që e aftëson njeriun të plotësojë misionin që Hyji ia ka besuar në jetën e tij. Pra, nëse më shëndet kuptojmë vetëm mirëqenien fizike (organike) të njeriut, kemi të bëjmë me një vizion zvogëlues që realisht e shkelë dinjitetin e vërtetë të personit, sepse kjo do të bënte që të harrojmë dimensionin psikologjik, sociologjik, etikë dhe shpirtëror të shëndetit të përgjithshëm të njeriut.

Pas kësaj paraqitje të sintetizuar mbi personin dhe shëndetin integral të tij, dëshiroj të kthehem te fjalët e Martinit, i cili në librin e tij mbi trupin flet për sëmundjen si pjesë të paevitueshme të jetës (përvojës) së njeriut.

Pohimi i Martinit se sëmundja është pjesë e jetës, praktikisht domethënë se nuk ekziston sëmundja, por ekziston personi i sëmurë, ashtu sikurse nuk ekziston shëndeti në vetvete, por ekziston personi i shëndoshë. Në këtë vizion, sëmundja konsiderohet si ndërprerje, peshë, ngacmim dhe provokim për jetën e njeriut. Sëmundja “nuk është një aksident, por zbulimi i gjendjes normale të limitit apo kufizimit që është i pranishëm në çdo kënaqësi njerëzore, ajo është diçka që më përkufizon si qenie e thyeshme, e dobët dhe e pasigurt.

Sëmundja zbulon qartësisht atë që është e fshehur në mua edhe atëherë kur jam mirë. Zbulon atë që e kam frikë: sëmundjen, sepse nuk dëshiroj që të dalë në dritë e vërteta e kufizimit dhe e varfërisë sime” – thoshte Martini.

Nuk duhet harruar se pikërisht në përvojën e sëmundjes dhe të frikës së infektimit dëgjohet fjala ngushëlluese e Jezusit: “Mos keni frikë” (Krh. Mt 4, 35- 41). Jezusi nuk e thoshte këtë për ta nënvlerësuar frikën e nxënësve të vet, por për t'i siguruar ata se realisht është dikush më i madh dhe më i fuqishëm se rreziqet që mund ta kërcënojnë shëndetin (harmoninë) tonë. Thirrja mos keni frikë, është thirrje në besim e vlefshme për të gjithë, sidomos sot kur po jetojmë në frikë dhe panik nga kjo pandemi e quajtur *coronavirus*.

Don Nosh GJOLAJ

Podgoricë

NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE

(Pjesa e katërt)

Dashuria – drejta, po por jo obligimi

Pohimi se martesë është bashkimi më i plotë në mes mashkullit dhe femrës, është edhe platforma e shumë diskutimeve mbi natyrën e besnikërisë në gjirin martesor. Po qe se e marrim besnikërinë si imperativ moral, që ndërlihet me rrethanat apo situatën konkrete, atëherë është e qartë se te kurora e martesës është e pandashme si dhe nuk ka arsye të diskutohet për divorcin e saj. Dhurimi i plotë mes mashkullit dhe femrës e krijon imunitetin kundra tundimit nga prirjet seksuale me një tjetër mashkull përkatësisht me një tjetër femër. Çifti është i aftë për ta vlerësuar takimin me mashkullin apo përkatësisht me femrën tjetër, duke krijuar distancën kritike për mos ta përmbysin besnikërinë e kurorës si dhe ta mposhtin tundimin e përhershëm. Nëse shprehemi me fjalorin e trafikut, atëherë obligohen si burri ashtu edhe gruaja ti respektojnë drita e kuqe, gjatë grahës së makinës së jetës, sepse timonin e kanë në duart e veta, po ashtu edhe frenin. Po qe se lajmërohet nga ana e jashtëm ndonjë shenjë, se në kurorën e martesës

diçka nuk është në rregull: raportet nuk janë të plota, ka shmangie të vogla apo të mëdha, ndoshta tani të papashme të gjitha këto shpien në mënyrë graduale në vdekjen e dashurisë. Mund të themi se, asnjë kurorë martesë nuk është shkatërruar nga faji i atij të tjetrit, ose ai tjetri nuk ka asnjë farë mundësie, për t'u përzije në punët e atij apo e asaj, derisa është fjala për dashurinë e singertë. Për këtë besnikëria martesore si imperativ moral është në shërbimin e ruajtjes asaj fuqie të brendshme për mos ta shkelin besnikërinë, përndryshe në të kundërtën shumë shpejtë kurora do të shkatërrohet si dhe do të shuhet dashuria e saj. Po qe se është një mbrojtje e tillë e nevojshme atëherë mund ta shfrytëzojë bisedën si dhe ringjalljen e dashurisë përparëse të shuhet kurora e martesës.

Shpeshherë vjen nga njerëzit jo me baraspeshë normale e çifteve si dhe nga dinamika e natyrës së njeriut.

Pohimi analog dëshiron ta çlirojnë kurorën e martesës nga detyrimin si dhe nga imperativi moral. Detyrimet e martesës nuk janë të imponuara nga bota e jashtëm, por janë frytë i zgjedhjes së lirë si dhe



mënyrës së jetës së sotme, që ia imponon natyra e lidhjes së martesës. Po qe se mashkulli vendos, që ai tjetri të bëhet pjesa e dyte e jetës së tij, për të jetuar me një grua konkrete, me këtë merr edhe detyrimin, që do të kujdesohet për të ta veshin, ta ushqejë. Po qe se mashkulli jeton me një grua në marrëdhëniet e plota seksuale, veprimtaria e tij seksuale, për t'ia shuar gruas etjen e seksit, nuk janë obligime, por ai do t'i mbesin besnik nga arsyeja, që nuk kanë asgjë çka të bëjnë me ligjin moral. Të gjitha këto edhe shumë gjëra të tjera do ta bëjnë për arsye, sepse ndryshe nuk mund të veprojnë. Po qe se mashkulli e merr mbi veten detyrimin ndaj gruas si dhe ndaj fëmijëve si diçka që i imponohet nga arsyeje e edukimit dhe nga ndërgjegjja, atëherë ligji i tij është i formuar në rëren dhe jo në shkëmb, ndërsa ditët janë të numëruara. Kurora e martesë kuptohet në këtë frymë nuk mund të qëndrojnë gjatë. Sepse ajo është e ndërtuar në ligjin formal të moralit të ndalesave.

Në këtë koncept të martesës fshihet diçka më shumë. Mësipërm e theksuam se dashuria rritet ose vdes. Martesa është diçka krejtësisht tjetër: kur mashkulli vendosë për këtë grua konkrete dhe me atë edhe martohet, kurora e martesës bëhet detyrim dhe mision, të cilën duhet të realizohet. Ashtu dalin në pah vendosmëria personale: mashkulli dhe femra e marrin përgjegjësinë e plotë të martesës, ku e vulosen me kurorën e sajë sakramentale. Kurorën e marrin si diçka të re, si njësi mbi personale, që iu imponon shkëmbimin e ndërsjellët. Kjo ndjenjë e njeriut se është në shërbimin diçka që është më tepër se vetvetja, është themeli si dhe kriteri i raporteve në mes mashkullit dhe femrës. Përvojat e përbashkëta behën edhe më të forta si dhe më të sigurta që e ruajnë nga çdo lloj tundimit etjes epshore. Atëherë në gjirin martesor nuk ka më vend xhelozia, frika, ankthi, pasiguri ose mos besnikëria.

Sepse dashuria e pjekur e paraqet bashkësinë, e cila është themeluar njëherë dhe do të zgjasin tërë jetën, deri në vdekje. Ndërsa dashuria e papjekur vepron në të kundërtën, e cila manipulohet nga bota e emocionale, që kalon nga dashuria deri në urrejtje. Te e para është stabiliteti ndërsa te e dyta lëkundje.

7. Terapia dhe proceset grupore në kultivimin dhe ruajtjen e martesës

Njeriu me të vërtetë është kafshë sociale. Ne e kalojmë një pjesë të madhe të jetës sonë në grupe: në gjirin e martesës, në familje, me shokë, me klasën, në klube, në organizata, në firma. Megjithatë jo çdo bashkim njerëzish formon grup: disa njerëz që qëndrojnë në radhë për të hipur në autobus janë thjeshtë një grumbull individësh. Ndryshimi midis një grupi dhe një grumbulli njerëzish qëndron në

faktin se anëtarët e grupit ose bashkësia martesore e konsiderojnë vetveten anëtarë grupi, kanë qëllime të përbashkëta dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin mbi këtë bazë.

Çdo grup si dhe bashkësia martesore funksionon mbi bazën e normave – rregulla të shkruara ose të pashkruara dhe standarde që rregullojnë sjelljen e anëtarëve që marrin pjesë në situatën e grupit. Normat mund të ndryshojnë nga grupi në grup dhe varën nga situata vlerat dhe objektivat të cilat anëtarët e tij i konsiderojnë të rëndësishme.

Sipas studimeve të Leon Festinger të vitit 1953 dy faktorë e shpjegojnë shkakun e nevojës së grupeve për të pasur norma. Njëri është dëshira për të forcuar qëndrimet e përbashkëta duke arritur marrëveshje për çështjet përkatëse dhe mënyra e veprimit. Anëtarët e grupit kalojnë një kohë shumë të madhe duke diskutuar përditë dhe duke u marrë vesh për çështjet themelore që i kanë bashkuar ata që në fillim. Pa pasur norma që mund të stabilizojnë grupin, që sigurojnë funksionimin e tij normal e të kënaqshëm për palët, grupi nuk mund t'i arrijë qëllimet e veta dhe të ruajë besnikërinë e anëtarëve të vet.

Sipas Steiner (1972) janë disa tip detyrash që mund të kryejnë grupet dhe produktivitetin e grupeve dhe të individëve. Në detyrat me shtim ndihmesat e anëtarëve i shtohen njëra-tjetrës në produktin përfundimtar grupit. Për shembull, shtyrja e një automobili që ka ngecur në baltë kërkon përpjekjet e secilit dhe grupi është më efikas sesa individ. Në detyrat veçuese gjithë grupi ka një problem të vetëm për të zgjidhur. Zakonisht zgjidhjen e gjen personi më i aftë i grupit. Një grup njerëzish që punojnë kolektivisht kanë më shumë mundësi ta gjejnë përgjigjen e saktë sesa një person që punon vetëm.

Një detyrë lidhëse kërkon që të gjithë anëtarët e grupit të punojnë për të arritur një qëllim dhe, edhe anëtari më pak i aftë duhet të jetë produktiv. Si bie fjala, një grup njerëzish janë të lidhur me njëri-tjetrin kur janë duke iu ngjitur një mali, çdo anëtarë merr rëndësi të madhe në rast se, qoftë edhe njëri nuk mbahet, atëherë grupi është efikas. Në këtë rast ndihmesa e individit është shpesh më e mirë se ajo e gjithë grupit.

Bibb Latane është përpjekur aktivisht të kuptojë ndikimin e të tjerëve mbi sjelljen sociale. Latane ka analizuar gjithashtu kur jemi pjesë përbërëse e një grupi, ne dukurimë e përtacisë sociale, sipas të cilit priremi të kontribuojmë më pak nga ç'mund të kontribuonin nëse do të ishin vetëm.

Kohët e fundit Latane i integroi shumë nga studimet e veta në një teori të re, të quajtur teoria e ndikimit social. Kjo teori përmban disa parime. Së pari, sa më shumë njerëz të jenë të pranishëm, aq më shumë ndikim do të kenë ata mbi secilin individ. Për

më tepër, sa më të rëndësishëm të jenë njerëzit për individin, aq më shumë ndikojnë ata mbi të. Kjo shpjegon se pse dikush është më i shqetësuar kur paraqet diçka para një grupi të madh njerëzish të rëndësishëm sesa kur grupi është i vogël e përbëhet nga miqtë e personit.

Së dyti, teoria e ndikimit social thotë se ndërsa ndikimi i të tjerëve mbi individin rritet kur rritet numri i njerëzve, përmasat e rritjes së ndikimit janë më të vogla kur individët shtohen një nga një. Së treti, çdo individ mund të ndikojë mbi të tjerët, por sa më shumë njerëz të jenë të pranishëm, aq më i vogël do të jetë ndikimi që do të ushtrojë individi. Kështu ne jemi më të pirur të dëgjojmë me vëmendje



folësin, kur ndodhet në një grup të vogël dhe më pak të pirur kur ndodhet në një grup të madh. Latane e ka vërtetuar teorinë e vet të ndikimit social në situata të larmishme.

Nganjëherë sjellja jonë është e ndryshme kur jemi përpara një grupi dhe ndryshe kur jemi vetëm. Teoria e Robert Zajonc thotë se prania e të tjerëve përshpejton çlirimin reagimit dominues të personit. Si rezultat, prania e të tjerëve shkakton një rritje të efikase, i cili ndikon në një rritje të reagimit dominues.

Në qoftë se reagimi dominues është një sjellje e mësuar mirë siç është të ngrënit, zgjidhja e problemave si bie fjala, në rastin tonë problemat bashkëshortore, atëherë prania e të tjerëve do të çojë zakonisht në një sjellje më të mirë.

Në disa grupe mbisundon konkurrimi, ndërsa në disa të tjera kooperimi. Faktorë të tillë si personaliteti i individëve, sasia e komunikimit, madhësia e grupit dhe reciprociteti përcaktojnë nëse individët konkurrojnë apo kooperojnë në një situatë

sociale.

Sipas këndvështrimit të teorisë së lojës, ekzistojnë dy lloj lojërash me interes: lojërat me shumë zero dhe lojërat me shumë pak zero. Në lojërat me shumë zero, totali i fitimit dhe i humbjeve është zero, ndërsa në lojërat me shumë pak zero, shumën e përgjithshme nuk është zero. Në lojërat me shumë pak zero, kooperimi ka vlerë përderisa të dy lojtarët kooperojnë, fitojnë dhe asnjëri nuk humbet. Ja dy lojëra me shumë pa zero:

Loja me kamion. Secili nga lojtarët zotëron një kompani kamionësh dhe përpiqet të nisë një dërgesë sa më shpejt që të jetë e mundur. Secili prej tyre ka një rrugë të gjatë deri në cakun dhe një rrugë të shkurtër

që bëhet një kalimi. Që të përdorin rrugën e shkurtër lojtarët duhet të bashkëpunojnë dhe ta përdorin rrugën një kalimi me radhë. Megjithatë çdo person kishte kontrollin e një porte për të penguar përdorimin e rrugës nga kompania tjetër e kamionëve. Rruga më e mirë është bashkëpunimi dhe, deri tani studiuesit kanë zbuluar se kur lojtarët kanë një armë (portën), pjesa më e madhe e kohës shpenzohet duke

konkurruar dhe duke kërcënuar tjetrin.

Në dilemën e të burgosurit; dy të burgosur janë izoluar nga njëri-tjetri dhe secili është akuzuar për krim. Në qoftë se të dy të burgosurit nuk e pranonin fajin, të dy do të marrin dënime të lehta (1 vit) dhe, në qoftë se të dy të burgosurit e pranojnë fajin të dy do të marrin dënimet të rënda (10 vjet). Në qoftë se njëri e pranon fajin dhe tjetri jo, ai që e pranon atë do të dënohet fare pak (tre muaj), ndërsa tjetri që nuk e pranon do të dënohet shumë rëndë (20 vjet). Gjatë serisë së hetimeve ekziston mundësia që të dy të burgosurit të kooperojnë dhe të mos e pranojnë fajin. Pas një serie hetimesh është me dobi për të dy të burgosurit të kooperojnë dhe të mos e pranojnë fajin, por prirja për të fituar vetë nxit konkurrimin duke e shtyrë të burgosurin të pranojë fajin dhe të shpresojë se tjetri nuk do ta pranojë atë. Edhe në këtë lojë subjektet shfaqin qartas konkurrencë.

Këto lojëra shpjegojnë ata faktorë që përcaktojnë nëse individi do të konkurrojë apo do të koeporojë.

Antonio Spadaro S.I.- Paul Twomey

NJË SFIDË PËR KISHËN INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE DREJTËSIA SOCIALE



Të varfrit në një botë të zotëruar nga “ngjarjet e mëdha”

Në epokën e inteligjencës artificiale, eksperiencia njerëzore po ndryshon rrënjësisht, më së shumti te pjesa më e madhe e popullsisë botërore, e cila mund të shohë dhe të mirëkuptojë. Shpërthimi i vërtetë e inteligjencës artificiale, ka një impakt të fortë mbi të drejtat tona të së sotmes e mbi mundësitë tona të së ardhmes, duke përfunduar procese vendimtare, të cilat në një shoqëri moderne, i përkasin të gjithëve. Tregohet një ndryshim i madh teknologjik, që projekton të mira të mëdha dhe rreziqe të fshehura. Proporcioni në të cilën rreziqet dhe të mirat do të paraqiten, do të varen nga pionierët dhe krijuesit e kësaj teknologjie, e veçanërisht nga vendi ku do të jetë i qartë vizioni i tyre, për një të mirë të përgjithshme dhe nga ana tjetër kërkohet të jetë korrekt mirëkuptimi ndaj natyrave njerëzore.

Duhet kuptuar që inteligjenca artificiale përfaqëson një sfidë dhe një mundësi edhe për Kishën: është një çështje e drejtësisë shoqërore. Në fakt, kërkimi i shtypur, lakmues dhe jo transparent i big data, për të ushqyer motorët e të kuptuarit automatik, mund të çojnë në manipulimin dhe shfrytëzimin e të varfërve: “Nga pikëvështrimi i atyre që nuk kanë të ardhura, të atyre që, në një mënyrë, lidhen me ngjarjet e me informacionet, të varfrit e shekullit XXI janë injoruar, naivë dhe të

shfrytëzuar. Nga ana tjetër, qëllimet e njëjta për të cilat ushtrohen sistemet e inteligjencës artificiale, mund të çojnë në një kundërveprim të paparashikueshëm, për të garantuar që të varfrit kontrollohen, vëzhgohen dhe manipulohen.

Aktualisht krijuesit e sistemit të inteligjencës artificiale, janë gjithnjë e më shumë arbitrit e së vërtetës për konsumatorin. Por në të njëjtën kohë, sfidat filozofike e esenciale, pra kuptimi i së vërtetës, njohja edhe etika- bëhen të flakta dorë pas dore dhe mundësitë e inteligjencës artificiale rriten drejt tejkalimit të limiteve njohëse të njerëzimit. Në kontekstin e zhvillimeve të shekullit XXI, eksperiencia dhe formimi i Kishës duhet të jenë një dhuratë ekzistenciale, që i ofrohet popullit për t'i ndihmuar ato që të formulojnë një kriter, me qëllim që të mundësojnë kontrollimin e inteligjencës artificiale, më shumë sesa kontrollimin e saj.

Inteligjenca artificiale prezanton një sfidë dhe mundësi edhe për Kishën

Kisha është e thirrur edhe për reflektim dhe angazhim. Në zonat politike dhe ekonomike, ku promovohet inteligjenca artificiale, konsideratat shpirtërore dhe etike duhet të gjejnë hapësirë. Mbi të gjitha, në shekullin XXI inteligjenca artificiale bëhet një disiplinë dhe një komunitet i etur nga evangjelizmi. Kisha duhet të gjunjëzohet për të informuar dhe frymëzuar zemrat e mijëra njerëzve

të përfshirë në krijimin dhe përpunimin e sistemeve të inteligjencave artificiale. Në analizën e fundit, janë vendimet etike për t'u vendosur në kornizë. Cilat do jenë problemet që do të përballojë një sistem i inteligjencës artificiale, si janë programuar ato e si duhet të mblidhen të dhënat për të ushqyer të kuptuarit automatik? Mbi kodin që shkruhet sot do të bazohen sistemet e së ardhmes së inteligjencës artificiale, që do vijnë pas shumë kohe.

Mund ta lexojmë sfidën e asaj që mund të përkufizojmë evangelizmin e inteligjencës artificiale, si një kombinim mes rekomandimit të papës Françesk, për ta parë botën nga periferia; gjithashtu për të parë eksperiencën e jezuitëve të shekullit XVI, ku metoda e tyre pragmatike për të influencuar se kush ka një ndikim të madh sot, duhet formuluar si një shpërndarje e mprehtësisë së të dhënave të shkencëtarëve.

Çfarë është inteligjenca artificiale?

Përkufizimi dhe ëndrra e inteligjencës artificiale na shoqërojnë për mbi 70 vite. Ky është kapaciteti i një kompjuteri, për të zbatuar aktivitete të përbashkëta të asociuara në njerëz, siç janë ato të arsytimit, të zbulimit të domethënies, duke përgjithësuar dhe mësuar nga eksperiencat e kaluara. Zhvillimi i inteligjencës artificiale ka kaluar përmes evoluimit të refleksionit, mbi atë si makinat mund të mësojnë, të shoqëruar gjithsesi së fundmi, në një zhvillim për mundësinë e llogaritjes. Inteligjenca artificiale ka qenë ideja e parë, nga e cila është pasuar të mësuarit automatik dhe më së fundmi, të mësuarit e thellë.

Basic Machine Learning është niveli i parë i inteligjencës artificiale. Parashikon futjen tradicionale të të dhënave brenda software, të shkruara me dorë dhe që zotërojnë një bashkësi udhëzimesh specifike, për të realizuar një detyrë konkrete. Me fjalë të tjera, përdor algoritme për të porositur sasi të mëdha të dhënash; ndërton një model matematik duke filluar nga ato; prandaj zbaton përkufizime dhe parashikime për këto aktivitete, pa udhëzime specifike paraprake. Rezultati është një detyrë e kryer- prandaj është quajtur Narrow AI-, por veprimi zbatohet më mirë sesa mund ta bëjnë qeniet njerëzore. Mes shembujve të Narrow AI, mund të citojmë aktivitete si klasifikim të imazheve apo njohje fytyrash.

Rrjetet janë një seri algoritmesh, të modeluara veçanërisht mbi shembullin e mendjes njerëzore, të cilat përpunojnë të dhënat, duke pasur parasysh shtresa dhe lidhje të ndryshme, të veçuara, për të njohur modelet dhe për të formuar një analizë parashikuese. Jepet të kuptuarit e thellë, kur shumë

rrjeta nervore janë të lidhura mes tyre dhe ushtrohen me sasi të mëdha të dhënash, në mënyrë që të mund të mësohet dhe formulohet në mënyrë automatike prezantime mes elementeve, të cilat nuk i janë përfshirë njerëzve.

Të mirat

Në mënyrë të heshtur, por të shpejtë inteligjenca artificiale po rimodelon thellësisht ekonominë dhe shoqërinë. Kjo dallohet te mënyra se si ne votojmë, e cila është mënyra se si stërvitet qeveria, policia predikuese, mënyra se si juristët përhapin fjalitë, mënyra se si i përdorim shërbimet që blejmë, zakonet që kemi, mjetet e komunikimit që përdorim, lajmet që lexojmë, përkthimi automatik i zërit dhe i tekstit. Inteligjenca artificiale projektton makinat tona, ndihmon në mënyrën se si t'i nisim dhe na orientojnë në lidhje me territorin, vendos se si të marrim një hua për blerje, vendos se cilat rrugë duhet të riparohen, siguron që kemi shkelur kodin rrugorë, madje na bën të ditur se, nëse do kishim bërë ndonjë shkelje, atëherë rrjedhimisht do të kishim përfunduar në burg. Këto janë vetëm disa nga veprimet që inteligjenca artificiale mund të bëjë.

Inteligjenca artificiale mund të grumbullojë dhe vlerësojë më shumë të dhëna dhe elementë sa mund të bëjë një qenie njerëzore. Rrjedhimisht, zvogëlon rezultatet e pjesshme ose pak të qarta, në bazë të të cilave ne vetë i marrim vendimet. Mes shembujve të mundshëm, na ngacmon parandalimin e gabimeve mjekësore, që shton produktivitetin dhe zvogëlon rreziqet në vendet e punës. Të mësuarit automatik mund të përmirësojnë përshkrimet e vendeve të punës, prandaj propozon procese më të mira seleksionuese. Të programuara mirë, algoritmet mund të jenë më shumë të paanshme dhe që pranojnë modele, që do t'i shpëtonin vlerësimit kritik të qenieve njerëzore.

Studiuesit Mark Purdy dhe Paul Daugherty shkruajnë: "Parashikojmë se impakti i teknologjive të inteligjencës artificiale mbi kompanitë, do të shkaktojë një shtim të produktivitetit të punës deri në 40 %, duke i lejuar njerëzve që të përdorin kohën e lirë në një mënyrë më efikase". Banka botërore është duke eksploruar të mirat që inteligjenca artificiale mund të çojnë në zhvillim. Të tjerë vëzhgues identifikojnë në agrikulturë, në dispozitën e burimeve dhe në asistencën sanitare, sektorët e ekonomisë në rrugën e zhvillimit. Këto janë një e mirë e madhe e aplikacionit të inteligjencës artificiale.

Inteligjenca artificiale për të drejtën sociale

Inteligjenca artificiale padyshim që mund t'i sjellë të mira shoqërisë, po që nga ana tjetër vendos dhe çështje të rëndësishme të së drejtës shoqërore. Në këtë kamp, Kisha ka mundësinë dhe detyrimin që ta bazojë të mësuarin e saj, zërin e saj dhe autorizimin e saj vetjak rreth disa çështjeve, që do jenë thelbësore për të ardhmen. Mes këtyre patjetër që do të përfshihet impakti i madh social, që evolucioni teknologjik do të merret me miliarda persona rreth dhjetëvjeçarit të fundit, duke krijuar kështu problematika konfliktuale dhe nga ana tjetër një përfshirje në masë e njerëzve më të varfër. Impakti i profesionit. Shumë gjëra janë bërë për të matur impaktin e inteligjencës artificiale dhe robotikës së profesionit, sidomos pas artikullit të 2013, ku Osborne e Frey vlerësonte që 47% e vendeve të punës në Shtetet e Bashkuara rrezikonin që të automatizoheshin brenda njëzet vjetëve të ardhshme. Studimet dhe debatet shkencore kanë theksuar natyrën dhe konturet e fenomenit: ndërprerja tërësore apo e pjesshme e aktivitetit të punëve ekzistuese, rënia e saj në të gjithë sektorët. Ky fenomen qëndron në ekonominë e zhvilluara, të zhvilluara dhe ato që janë drejt rrugës së zhvillimit. Sigurisht, për të bërë parashikime të sigurta për sa po flitet, është e vështirë, po një raport i bërë së fundmi nga McKinsey Global Institute sjell një analizë, ndonëse të papërfunduar. 60% e profesioneve zotëron të paktën 30% të aktiviteteve përgjegjëse automatike. Nga ana tjetër, kjo e fundit do të hapë dyert për profesione të reja, që sot nuk ekzistojnë, pikërisht ashtu siç ka ndodhur edhe në të kaluarën. Parashikimet tregojnë se brenda 2030-ës, një numër mes 75 dhe 375 milion të punësuarish (pra mes 3 dhe 14% të fuqive punëtore globale), duhet të ndryshojnë kategoritë e veta të të punësuarit. Edhe të gjithë të punësuarit do të ndiejnë nevojën e përshtatjes, duke qenë se punët e tyre do të bashkohen me makinat gjithnjë e më shumë të nevojshme. Por, nëse përshtatja e teknologjive të reja do të ndjekë ritmin që ka mbajtur deri tani, duke kaluar parashikimet e bëra më përpara, është e qartë që niveli i përmbysjes sociale do të qëndrojë në nivel më të lartë.

Kodet dhe paragjykimet. Kodi i programimit shkruhet nga njerëzit. Kompleksiteti i tij mund të theksojë defektet që në mënyrë të pashmangshme shoqërojnë çdo detyrë që ne zhvillojmë. Paragjykimi dhe ndarja në shkrimet e algoritmeve janë të pashmangshme. E mund të kenë efekte negative mbi të drejtat individuale, zgjedhjet, mbi rendin e punëtorëve dhe mbi mbrojtjen e konsumuesve.

Në fakt, kërkuesit kanë treguar paragjykime të llojeve të ndryshme, të prezantuara te algoritmet, në softweret e përshtatura për pohimet universale, resurset njerëzore, vlerësimet e kreditit, bankave, sistemeve të mbështetjes në fëmijëri, pajisjet e sigurisë shoqërore e prapë të tjera. Algoritmet nuk janë neutrale: mishërojnë vlerat e brendshme dhe i binden metodave operative, të cilat edhe pse në një mënyrë ta pavetëdijshme, mund të sjellin pengesa, diskriminime dhe dëme ekonomike. Varësia në rritje e socio-ekonomisë së inteligjencës artificiale shfaq një fuqi të madhe të atyre që projektojnë algoritmet: një fuqi për të cilën mund të mos jemi të vetëdijshëm; ashtu siç mund të jetë i dëmshëm përdorimi i një algoritmi, të cilit ia kemi vendosur gabim kodin. Është e mundshme edhe se algoritmet sot ekzistuese, që deri dje ishin të padëmshme, nesër mund të kenë vijueshmëri demaskuese. Inteligjenca artificiale mund të shtrembërohet përmes interesave specifike, komerciale dhe politike, që influencojnë theksimin e problemit; paragjykime të seleksionimit apo korruptimit në mbledhjen e të dhënave; ndarje në mënyrë të barabartë të attributeve të selektimit për përgatitjen e të dhënave. Nga këtu mund të rrjedhin të dhëna domethënëse të kushtëzuara, e megjithatë të etiketuara si pjesë e një procesi vendimtar të automatizuar në mënyrë të pavarur.

Rreziku i përfshirjes në një masë më të madhe të prekshme. Një analizë për impaktin e “big data”, dhe në inteligjencën artificiale në një nivel social, tregojnë që tendenca e tyre për të marrë vendime mbi bazën e profilizimit të pamjaftueshëm dhe të takimeve të limituara sjell përfshirjen më të madhe të të varfërve, të nevojtarëve dhe të njerëzve të prekur.

Shkencëtarja politike Virginia Eubanks shpjegon mirë se si sistemet e ndërlidhura, forcojnë diskriminimin dhe i japin mundësinë më të vogël të dëbuarve. Të varfrit dhe klasat punëtore janë shënjuar nga strukturat drejtuesve të varfërisë digjitale, me rezultatin që pritet të kenë një vazhdueshmëri të rrezikshme për ekzistencën e tyre. Sistemet automatike të pranueshmërisë i dekurajojnë rezervat publike, për të cilat kanë nevojë për të mbijetuar e për të qenë mirë. Këto database të integruar mblodhën informacionet më personale mbi to, me një vështirësi më të paktë rreth privatësisë apo sigurisë së të dhënave, për të mos ofruar gati asgjë në këmbim. Modele dhe algoritme parashikuese i krahasojnë me investimet e rrezikshme dhe prindërit problematikë. Sisteme të tilla komplekse të asistencës sociale të aplikimit të ligjit e bëjnë të dukshme çdo gjest të tyre dhe e

mbështesin sjelljen e tyre me kontrollin qeveritar, komercial dhe publik.

Përfshirja e shoqërisë dhe e qeverisë

Viteve të fundit përfshirja e shoqërisë dhe e qeverisë është parë si një kërkesë në rritje, që i bëhet qeverive nga teknikët dhe shkencëtarët e autorizuar nga sindikata, nga shoqëria shoqërore dhe nga vetë kompanitë teknologjike, për të ndërhyrë e për të garantuar një kontroll dhe një prani të vlerave njerëzore në zhvillimin e inteligjencës artificiale. Një zhvillim domethënës është bërë në maj të 2019, ku 35 qytetet, të përfshirë në OSCE, kanë pranuar një dokument që sjell “Principet e OSCE-së mbi inteligjencën artificiale. Këto përfshijnë “Linjat për një guidë etikem që sjell inteligjencën artificiale të besueshme”, këto të adaptuara në prill të të njëjtit vit.

Objekti i dokumentit të OSCE-së është promovimi i një inteligjence artificiale inovative dhe të besueshme, që respekton të drejtat njerëzore dhe vlerat demokratike. Në këtë përfundim ajo identifikon pesë principe, nga të cilët janë plotësues dhe pesë rekomandime relative ndaj politikave shtetërore dhe bashkëpunimeve internacionale. Principet janë: të favorizuarit e rritjes gjithëpërfshirëse, zhvillimi mbështetës dhe mirëqenës; të respektohen të drejtat njerëzore, të drejtat e njeriut, principet demokratike; të zotërohen sisteme transparente dhe të kuptueshme; të garantohet siguria, mbrojtja dhe vlerësimi i rreziqeve; të pranuarit e përgjegjësisë për atë që i zhvillon, i shpërndan dhe i drejton. Rekomandimet janë: të investuarit në kërkimin dhe zhvillimin e inteligjencës artificiale; të promovuarit e ekosistemeve digjitale të inteligjencës artificiale, të krijuarit e një ambienti politik të përshtatshëm për inteligjencën artificiale; t'i krijosh njerëzve



kompetencat e duhura për transformimin e tregut të punës; të zhvillohen bashkëpunimet internacionale, por edhe një inteligjencë artificiale e përgjegjshme dhe e besueshme. Në qershor 2019, G20 ka marrë në shqyrtim “Principet e OSCE-së”, për t’ia përshtatur inteligjencës artificiale. Sfidat për vitet e ardhshme është dyfishe: shpërndarja e madhe e tyre dhe zhvillimi i iniciativave konkrete për t’i vënë në praktikë brenda G20-ës. Për Kishën tani hapet një mundësi për të reflektuar mbi këto objektiva politike dhe për të ndërhyrë në karriget lokale, nacionale dhe internacionale për të promovuar një perspektivë koherente në doktrinën e tyre sociale.

Të evangjelizohet inteligjenca artificiale?

Sado të rëndësishme të jenë sugjerimet në nivel politik dhe social, qëndron i vlefshëm fakti që inteligjenca artificiale, është e formuar nga sisteme projektimi, programimi, të grumbulluara nga zhvillimi i të dhënave. Të gjithë proceset të kushtëzuara fortësisht nga individët. Do të jenë mentalitetet dhe vendimet e atyre për të vendosur se në cilën masë, në të ardhmen, inteligjenca artificiale do të përshtatë kritere etike të përshtatshme për njeriun. Aktualisht këto individë do të ndërtojnë një elitë teknike programuesish dhe ekspertë të dhënash, mundësisht të përbërë nga një numër personash që i afrohet më shumë qindësës apo mijëshes sesa milionave.

Tani të krishterëve apo Kishës i hapet një mundësi për zhvillimin e kulturës së takimit. Për t’i sjellë ekspertëve të të dhënave dhe inxhinierëve të softwerëve vlerat e Ungjillit dhe eksperiencën e thellë të Kishës në etikën dhe drejtësinë shoqërore, e cila është një bekim për të gjithë, kjo është një metodë më e pëlqyeshme për ta ndryshuar për më mirë kulturën dhe praktikën e inteligjencës artificiale.

Evoluimi i inteligjencës artificiale do të kontribuojë në një masë të madhe për të modeluar shekullin e XXI. Kisha është thirrur për të dëgjuar, reflektuar dhe angazhuar duke i pretenduar një kornizë etike dhe shpirtërore komunitetit të inteligjencës artificiale. Në këtë mënyrë ajo do të shërbejë komunitetit universal. Duke ndjekur traditën e Rerum novarum, mund të thuhet që këtu vërehet një thirrje e drejtësisë shoqërore. Zëri i Kishës është i domosdoshëm në debatet politike që zhvillohen, të destinuar për të përkufizuar dhe përshtatur parimet etike për inteligjencën artificiale.

*Përktheu: Bernardina Shahini
nga “La civiltà cattolica”, 2020.*

NXËNËSIT PRESIN NGA EDUKUESIT TË KUPTOJNË E TË MËSOJNË SE SI DO TË JETOJNË!

**Letër e Mons. Angelo Massafra, drejtuar:
Komisionit Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar, KKEKSH
Shkodër, 7 Mars 2020.**

Të dashur mësuese e mësues,
ndjehem i privilegjuar t'Ju përcjell urimet e mia dhe në tërësi të Komisionit Kombëtar të Edukimit Katolik në Shqipëri në këtë ditë të veçantë për ju si ajo e 7 Marsit, ditë që simbolizon dhe njohjen e vlerave të veçanta të rolit tuaj në gjithë historinë ndërtuese të brezave në vatrat e Shkollave dhe jo vetëm.

Të Edukosh, në leksikun e përditshëm na vjen me domethënien, nga latinishtja *educere*, “të nxjerrësh në pah në dritë, të rritësh, të shoqërosh” e përkthyer në *promovimin dhe zhvillimin e aftësive intelektuale, estetike dhe morale të personit nëpërmjet shembullit dhe mësimdhënies*.

Në këtë mision të rritjes së brezave, ju si mësues, gjithashtu keni privilegjin të jeni të thirrur si një dritë në jetët e fëmijëve që ju janë besuar nga prindërit e familjet me vullnetin e një pune të përbashkët për mirërritjen në të gjithë dimensionin e personit të tyre njerëzor. Këto krijesa të dashura e unike, presin edhe nga Edukuesit e vet të kuptojnë e të mësojnë se si do të jetojnë, të kuptojnë ç'burra e ç'gra dëshirojnë të bëhen në të ardhmen.

Ndaj dhe përveç privilegjit të madh, ne, si ambiente edukative, bashkë me Ju të dashur mësues, kemi detyrën dhe përgjegjësinë të mos e tradhetojmë këtë pritshmëri të fëmijëve në bashkëpunim të ngushtë me prindërit, familjen dhe me komunitetin, sepse siç edhe Papa Françesco shpesh na e sjell ndërmend, një proverb afrikan thotë “*për të edukuar një fëmijë duhet një fshat i tërë*”. Duke u nisur nga kjo, Ati i Shenjtë, që në shtator të vitit 2019 ka shpallur një iniciativë: “Paktin Edukativ Global”, e cila do të konkretizohet më datë 14 maj 2020 kur të gjithë personat e përfshirë në fushën e edukimit dhe të formimit, sikurse dhe të rinjtë, do të takohen me Atin e Shenjtë në Romë për një ditë dialogu mbi këtë temë. Fokusi dhe konteksti do të jetë mbi ndryshimet e vullshme epokale, fryt i teknologjisë së kohës sonë tashmë të digjitalizuar, ndryshime të cilat, për shpejtësinë e tyre, nuk respektojnë ngadalësinë e evolucionit biologjik natyral të njeriut dhe prandaj gjenerojnë dhe çorientim psikologjik për shkak të ndryshimit të vazhdueshëm të pikave të referimit.

Gjithashtu ka dhe një tjetër efekt të cilin e përmend Ati i Shenjtë, ai i eliminimit në mënyrë të pa diskriminuar të asaj që historia na ka dorëzuar, besuar, si mësim. Si rrjedhojë bartim të madh rrezikun që të përsërisim të njëjtat gabime të rënda të ndodhura dhe më parë.

Dëshira e Papa Françeskut është që të mund të hapet një debat midis të gjithë subjekteve edukuese, përfshirë dhe mësuesit, duke realizuar atë që ai e quan “*fshati i edukimit*”, një vend marrëdhëniesh njerëzore të hapura duke u nisur nga eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit e duke e zëvendësuar atë me vëllazërinë.

Papa na jep dhe një metodë me disa hapa që duhen ndjekur në këtë rrugëtim:

1. Vënia në qendër e personit. Që do të thotë të kemi një mënyrë të re me të cilën kuptojmë ekonominë, politikën, rritjen dhe progresin, duke e kapërcyer *kulturën e skartimit*.

2. Të investojmë energjitë më të mira me kreativitet dhe përgjegjësi, duke e kapërcyer ngutën dhe duke i dhënë hapësirën dhe kohën e mjaftueshme dialogut dhe reflektimit.

3. Formimi i personave të gatshëm t'i shërbejnë komunitetit, duke kapërcyer individualizmin dhe egoizmin në të gjitha fushat.

4. Nuk mungon në brendësi të “*fshatit edukues*” ajo që Ati i Shenjtë e përcakton si “*shtëpia e përbashkët*”, bota e krijuar që duhet ta duam dhe ta mbrojmë.

Qëllimi i së tërës në fund është të krijojmë një botë më të mirë me persona më të mirë.

Lë të provojmë të imagjinojmë se ç do të thotë e gjitha kjo për kontekstin tonë shqiptar që, më tepër se shumë vende të tjera, ka bërë një hov nga “*asgjëja*” në “*gjithëcka*” në erën digjitale, pa përjetuar kalimet që popujt e tjerë i kanë përjetuar në kohë të ndryshme.

Më tepër se shumë popuj të tjerë, i yni, është subjekt i rreziqeve që Papa Françesku na paraqet, e ndaj me tepër se çdo popull tjetër kemi nevojën e një *Pakti Edukativ* që gjeneron dialog për identifikimin e risqeve që na kanosen (e që mbase tashme dhe po i jetojmë) dhe të jemi të hapur ndaj skenarëve të reja të mundshme, që nuk janë ato të zakonshmet me të cilët jemi mësuar, ku personi njerëzor është viktimë e logjikave dhe i interesave politike dhe ekonomike, ku burimet njerëzore më të mira largohen nga vendi, dhe angazhimi i individëve ka në fokus vetëm arritjet e menjëhershme dhe egoiste në kurriz të së mirës së përbashkët, ku jemi larg me mijëra kilometra nga përkujdesja dhe vlerësimi i burimeve natyrore në dispozicion, veçse për një shfrytëzim, madje, hera herës, i “shesim lirë” dhe tek të tretë.

Ende nuk po flitet për të gjitha këto por shpejt, jemi të sigurt, “*fshati i edukimit*” do të jetë subjekt diskutimi dhe vëmendje për të gjithë, përfshirë dhe ne, si Kishë në Shqipëri. Shpejt do të dimë të përfshihemi në këtë iniciativë të bukur të Françeskut.

Urime dhe njëherë në misionin tuaj e Ju përcjell bekimin tim atëror.

**+ ANGELO MASSAFRA OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult
President i Komisionit për Shkollat Katolike në
Shqipëri**

EJANI TEK UNË TË GJITHË JU QË JENI TË LODHUR PREJ BARRËS SË RËNDË

Dita Botërore e të sëmureve dhe punonjësve të shëndetësisë

Shkodër, 11 shkurt 2020

Virgjër Mari, Shëndeti i të sëmureve, t'i besoj të gjithë personat që janë duke mbajtur peshën e sëmundjes, së bashku me familjarët e tyre ashtu si dhe të gjithë punonjësit e sistemit shëndetësor. Të gjithëve me dashamirësi, ju siguroj afritetin tim në lutje dhe ju jap me zemër Bekimin Apostolik. Papa Francesku.

Me 11 shkurt 2020 në Shkodër në Katedralen Shën Shtjefni në orën 15.00 ka filluar Meshja e Shenjtë e drejtuar nga Dom Vlasi Palaj dhe bashkëcelebriu nga Dom Gjergj Simoni, Dom Gasper Kola dhe Fretërit Kapucinë Fra Landi dhe Fra Dario. Pas Meshës së Shenjtë është vazhduar me adhurimin eukaristik dhe procesionin në Kishë. Dom Vlasi ka bekuar të sëmuret me të Shenjtënueshmin Sakrament dhe Vajin e Shenjtë. Kori i Katedrales “Nënë Tereza” drejtuar nga M. Luiza Milani dhe Lukë Mllugja ka shoqëruar Meshën me këngët kushtuar kësaj dite. Në sallën Mikel Koliqi, në orën 16.00, të rinjtë dhe të rejtat e Qendrës Shtetërore të Zhvillimit, Shkolla

Speciale 3 Dhjetori, Projekti Shpresa, Madonnina del Grappa dhe të M. Nënë Tereza kanë dhënë një program artistik që është prezantuar nga Ketlin Pjalmi. Në program u lexuan pjesë nga Mesazhi i Papa Franceskut në kuadrin e kësaj dite: « Ejani tek unë të gjithë ju që jeni të lodhur prej barrës së rëndë e unë do t'ju çlodh. » (**Mt 11, 28**)

Dom Vlasi ka përshëndetur të pranishmit në emër të Arqipeshkvit Mons. Massafra, i cili ndodhej jashtë Shqipërisë: “ *E di se Mons. Massafra është miku juaj dhe çdo vit është i pranishëm në këtë festë, por, jam i sigurt se sot në mëngjes në meshë ai i është lutur Jezusit për ju.* Dom Vlasi gjithashtu ka kujtuar e falenderuar Don Carlo Zaccaro e Silvana Vignali për kontributin e tyre për personat me aftësi ndryshe dhe të sëmuret si dhe ka falënderuar personelin dhe vullnetarët që vazhdimisht çdo ditë, çdo moment kujdesen për këtë kategori.

Falenderojmë Famullinë Shën Shtjefni, Korin Nënë Tereza, shoqatat dhe institucionet e lartpërmendura të cilat çdo vit me 11 shkurt bashkëpunojnë me Caritasin Dioqezan (Sektorin e Shëndetësisë) që drejtohet nga M. Ensa Ferrara.

Jolanda Marena

IN MEMORIAM: MISIONAR I PËRKUSHTUAR I KISHËS NË SHQIPERI

Dom Michelangelo Braga (1939-2020)

Ju bëj me dije se gjatë paradites së sotme, datë 30 mars 2020, ndërroi jetë Dom Michelangelo Braga, i cili ishte shtruar në Qendrën Spitalore RSA Mons. Zani në Bienno (Brescia).

Për herë të fundit e kam takuar Dom Michelangelo-n më 12 dhjetor 2019 dhe gjatë këtij takimi kemi ngrënë edhe drekë bashkë.

Do të kremtohet privatisht Meshja e Salikimit me familjarët në të ardhmen. Ndërkohë, i kam dërguar Ipeshkvit, Imzot Pierantonio Tremolada-s, një letër ngushëllimi dhe falënderimi për pranimin e Dom Michelangelo Braga-s në Dioqezën dhe për përkujdesën që ka treguar ndaj tij.

Dom Michelangelo Braga lindi më 18.12.1939, në Brescia (Itali). U shugurua meshtar më 11.06.1966 (ishte anëtar i Kongregatës së Oratorit të Shën Filipit deri në vitin 1969). Për disa vite qe Zëvendës famullitar në disa famulli, pastaj gjatë viteve 1982-1993 qe famullitar në Palazzolo. Gjatë viteve 1993-2014 shërbeu si Meshtar misionar i përkushtuar në Shkodër. Po ashtu, gjatë këtyre

viteve qe edhe Sekretar i Imzot Frano Illisë dhe famullitar në Juban, si edhe shërbeu në disa famulli malore për shkak të mungesës së meshtarëve. Kur u kthye në Brescia qe meshtar bashkëpunëtor në Marone e Vello deri në vitin 2017.

Duke falënderuar Dom Michelangelo-n për shërbimin e tij në Dioqezën tonë, e lusim Zotin që ta pranojë atë në Parriz dhe kështu të takohet me të vëllanë, Dom Silvio-n, i cili vdiq më 8 shtator 2019.

Me 31 mars, do ta kremtoj Meshën e shenjtë për shpirtin e tij, duke u bashkuar kështu me kremtimin që ndërkohë do të jetë duke u zhvilluar në varrezat Bienno dhe pastaj do të varroset në Varrezat në Rodengo Saiano. Po ashtu, sugjeroj që çdo meshtar ta kremtojë një Meshë për shpirtin e tij.

Zoti e pastë në parajsë, Don Michelangelo-n dhe prej atje u lutë për ne.

† Imzot Angelo Massafra O.F.M.

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

DRITË PËRTEJ ERRËSIRËS

*Dita e kujtesë! Me rastin e 30 vjetori të lirisë fetare në Shqipëri,
organizuar nga Instituti për Demokraci Medie e Kulturë.
Shkodër, 15 shkurt 2020.*

Para së gjithash ju falënderoj për nismën, për ftesën dhe për kohën që më keni dhënë me këtë rast që, edhe një herë tjetër, dhe sidomos këtë vit që bie 30-vjetori i hapjes së vendeve të kultit dhe i kthimit të lirisë fetare në Shqipëri, bëhet një kënd shumë i mirë reflektimi për të gjithë ata që ende nuk e kanë humbur shijen e të reflektuarit.

Koha në të cilën jetojmë favorizon më shumë reagimet aty për aty mbi faktet dhe ngjarjet që karakterizojnë epokën tonë, sesa reflektimet e medituara, ku përdoren fjalë të peshuara mirë. Por kështu rrezikojmë të banalizojmë edhe atë që është e rëndësishme, duke thënë vetëm dy-tri fjalë për elemente historike që na kanë bërë të jemi sot këta që jemi, mirë apo keq.

Sipas mendimit tim historia është hallka e dobët e shoqërisë sonë sot. Dhe kjo në dy kuptime diametralisht të kundërta: ose e absolutizojmë atë, duke e paraqitur atë sipas nevojave dhe dëshirës së atij që e përdor, ose e nëpërkëmbim me justifikimin se kohët kanë ndryshuar dhe se nuk mund të jetojmë gjithmonë në të kaluarën. Në të dyja rastet, jemi duke mbajtur një qëndrim të gabuar.

Thuhet se historia është mësuese jete; për këtë arsye, ajo duhet të respektohet në të vërtetën e saj objektive, pa e keqpërdorur atë dhe duhet ta pranojmë mësimin e saj, me qëllim që të marrim atë që është e mirë dhe që të shmangim atë që është e keqe prej të kaluarës.

Ajo që ne duhet të bëjmë sot është ta marrim historinë, edhe atë që ende është afër nesh, dhe ta pranojmë në të vërtetën e saj, sado e dhimbshme që të jetë; ta trajtojmë atë me respektin e duhur për ata viktimë që, më shumë sesa kërkojnë hakmarrje, sot kërkojnë prej nesh që t'i shikojmë me sy të ndryshëm edhe xhelatët e tyre, viktimë edhe ata vetë, në një far mënyrë, të një kohë dhe të atyre dinamikave që jo shumë kohë më përpara karakterizonin gjithë botën. Kjo më duket se është domethënia e temës që jemi duke trajtuar: Dritë përtej errësirës. Janë ata fytyra burrash dhe grash të plagosur që sot, me ato plagë, bëjnë që të kalojnë rreze drite mbi një sfond të errët historik, që duam që të mos përsëritet më kurrë.

Pyetja ime, në këtë pikë, është kjo: a do të arrijmë të mësojmë prej historisë dhe të mos përsërisim më të njëjtat gabime? Kjo është sfida e vërtetë, kur mendojmë sesa me lehtësi (dhe me shpejtësi) në faqet e mediave, sidomos të atyre në internet, urrejta, kritika dashakeqëse, gjykimi i lehtë, arroganca e atij që mendon se di gjithçka dhe e atij që dëshiron që të tjerët të besojnë në një të vërtetë të rreme, sundojnë të pashqetësuar.

A mos ndoshta jemi duke rrezikuar të biem në të njëjtën errësirë, në të njëjtën klimë terrori dhe mosbesimi, që kaluan shumë vëllezër, edhe në mish, duke u bërë akuzues, gjykatës dhe xhelatë të vëllezërve të tyre?

Kemi vetëm një mënyrë për ta nderuar atë që ka dhënë jetën e vet për këto arsye: të kemi kujdes e të mos biem në errësirë! Për këtë gjë nuk duhet ta humbasim kurrë shpresën. Paradoksalisht, duhet të mësojmë ta shikojmë me dashamirësi edhe errësirën, sepse, siç thotë Fjodor Dostojevski, "Sa më e errët nata, aq më të shndritshëm yjet; sa më e thellë dhimbja, aq më afër Hyji!"

Ju uroj të gjithëve që prej paraqitjes së këtyre imazheve, fjalëve, kujtesave, emocioneve të frikës dhe të zemërimit, të lindë shpresa dhe dëshira për të shkuar përtej, duke u kapur me të gjitha forcat në atë "dritë që shndriti në errësirë e errësira nuk e pushtoi. Atyre që e pranuan u dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit" (Gjn 1,5.12).

Imzot Angelo Massafra O.F.M.





Raniero Cantalamessa

DËGJESA

Arqipeshkvia Shkodër - Pult
Shkodër, 2020



J. Attali / P.H. Salfati

FATI I PERËNDIMIT

Minerva, 2020



Alexandre Degrand

**KUJTIME NGA
SHQIPËRIA E EPËRME**

Plejad
Tiranë 2018

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë